

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7618 E diel 12 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Nga ZOJE JAKAJ



Java masakër dhe plot lot e dhimbje

Java që po mbylлим me plot gojë mund të konsiderohet horror. Një i ri 24 vjeç në Resulaj të Vlorës, që mund të jetë me patologji të pazbuluara të shëndetit...

Vijon në faqen 22

Opinion **i** Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI



Korrupsioni më i rrezikshëm, ai që harrohet!

Si qytetarë, po ndjekim me një vëmendje dhe pasion gati prej tifozi futbollit, aradhën e gjykatësve dhe prokurorëve që strukturat e vetingut po i largojnë me turp...

Vijon në faqen 21



Nata e katërt e festimeve, surprizat s'kanë fund

Manolito i "Gipsy King" ndez festën në Korçë, ambasadorja sllovene: "Birra Korça", shije unike

Lea Stançiq: Kam vizituar qytetin dhe fabrikën. Ua rekomandoj të gjithëve

Të 13 stendat e "Birra Korçës" ishin të mbushura me qytetarë nga e gjithë Europa, që erdhën në qytetin juglindor për Festën e madhe të Birrës, traditë kjo tashmë e konsoliduar. Festa që nis në 9 të mbremjes e që mbaron në orët e para të mëngjesit, djek pasur një kullm në natën e katërt të festimeve. Manolito i "Gipsy King Family" ka qenë i ftuari special, ndërsa hiti...

Në faqen 12

ARRESTOHET RIDVAN ZYKAJ: I VRAVA SE ME SHANIN HAJDUT. ME ARRESTUAT VONE

SELENICA NE ZI, PERCILLEN ME KUJE FAMILJARET E VRARE

Albi Zykaj, i vetmi që i shpëtoi masakrës së të premtes. Gjyshi: Si i gjeta trupat e pajetë të nipërve e vëllait. Përplaset politika...



(Në foto) Ceremonia e djeshme mortore në fshatin Resulaj. Autori i masakrës, Ridvan Zykaj

Në faqen 2-4

ÇFARË SHKRUHET

Hapet 30 vite pas vdekjes dosja e poetit Havzi Nela: Do të bindem vetëm kur të bëhem dhe...

Në faqen 11

SITUATA DHE DEMET

Lëkundja e 932-të brenda 1 muaji "shkund" disa qytete të vendit, dëmtohen rreth 70 banesa në Dibër

Në faqen 6

INTERVISTA

Altin Hazizaj: Shifra alarmuese, rreth 50 mijë fëmijë në Shqipëri detyrohen të punojnë

Në faqen 10

"MILOSAO"

Vdekja e profesorit Egerem Çabej, ja si është përcjellë nga propaganda serbe

Suplement

SI TË APLIKONI



Mbi 50 mijë biznese, në kërkim të 10 mijë punëtorëve, cilat janë zanatet më të kërkuarra

Në faqen 7

Përfituesit e kështit parë dhe të dytë, dokumentet në Drejtorinë e Pagesave

Ish-të përndjekurit, 650 trashëgimtarët marrin paratë

Ministria e Financave: Dorëzoni numrin e llogarisë dhe certifikatat

Nga ORNELA MANJANI

Rreth 650 fëmijë ish-të Rënuarish politikë, trashëgimtarë të radhës së parë do të marrin dëmshpërblimin. Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë joparësore në radhët e



ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të dorëzojnë dokumentet brenda 3 muajve. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të kështit të dytë të dorëzojnë në Drejtorinë e Pagesave...

Në faqen 8-9

MASAKRA NE VLORE SELENICA NE ZI

MOTIVI

Nga hetimet paraprake dyshohet se 24-vjeçari dhe familjarët e tij kishin zënka të vazhdueshme. Dyshohet se ai në momentin që ka kryer vrasjet ka qenë në gjendje të dehur. Mësohet se zënkat e vazhdueshme me të afërmit e tij kanë qenë për motive të dobëta.



CEREMONIA MORTORE

BASHKIA SELENICË JEP 12 MLN LEKË

Menjëherë pas ngjarjes së rëndë, Bashkia e Selenicës është mbledhur ditën e djeshme dhe ka marrë dy vendime. Këshilli Bashkiak ka shpallur ditë zie, ditën e hënë në Bashkinë e Selenicës, si dhe vendosjen në dispozicion të familjeve të viktimave një shumë prej 12 milionë lekësh të vjetra. Që në fillim të mbledhjes, Përparim Shametaj, ka kërkuar të mbahet një minutë heshtje në nderim të viktimave. Më tej, Shametaj foli edhe për familjen Zykaj, por edhe për autorin e masakrës, duke u shprehur se nuk njihet për rrezikshmëri kaq të lartë.

Masakra, Selenica përmbush amanetin, përcjell për në banesën e fundit familjen Zykaj

Mes lotësh dhe dhimbjeje, 8 viktimat varrosen në tokat e tyre

Vetëm tre djemtë mundën t'i shpëtonin ekzekutimit

Dita e djeshme ka qenë një ditë zie jo vetëm për fshatin Resulaj, por për mbarë opinionin publik. Nga familja Zykaj kanë dalë plot 8 arkivolë. Demir Zykaj, Ferie Zykaj, Besim Zykaj, Vasilika Zykaj, Sara Zykaj, Ledjon Zykaj, Azem Zykaj dhe Afërdita Zykaj janë përcjellë për në banesën e fundit mesditën e djeshme. Ridvan Zykaj ekzekutoi 8 pjesëtarë të familjes së tij ditën e premte, pas konflikteve që kishte pasur me ta. Kur Demir Zykaj kishte lënë amanet që të varrosej në tokat e tij, nuk e dinte që bashkë me të, aty do të prehej edhe e gjithë familja. Mes lotëve dhe vajtitimit me zë, të afërmit dhe i gjithë fshati kanë përcjellë familjen Zykaj për në banesën e fundit. Më e dhimbshme për familjarët ka qenë mbajtja dhe varrosja e dy fëmijëve të mitur të familjes. Sara dhe Ledjoni, në dy arkivolë të bardhë, prehen tashmë me gjithë familjen e tyre, fare pranë shtëpisë ku jetuan për ato pak vite. Edhe pse e kanë pasur të vështirë të pranojnë mediat në një dhimbje të tillë, familjarët e viktimave duket se kanë gjetur forcë që pas varrimit, të japin edhe një mesazh sensibilizues për të rinjtë shqiptarë. "Askund nuk është parë dhe degjuar një krim i tillë. Kjo është një gjëmë. T'u qëndrojmë pranë të rinjve për të mos bërë veprime të tilla. Shteti t'i gjejë vendin kriminelit", ka thënë një prej familjarëve mes dhimbjes dhe lotëve. Tashmë në fshatin Resulaj, tri shtëpi kanë hapur dyert e mortit. Tri shtëpi, tek të cilat mungojnë familjarët e tyre.

5

MINUTA

Ridvan Zykaj ka mundur që për 5 minuta të vrasë 8 persona të familjes së tij. Në një distancë prej 30 metrash, ai ka lëvizur në tri shtëpi, ku dhe ka vrrarë të gjithë pjesëtarët që ka gjetur brenda. Me kallashnikov në dorë dhe gjakftohtë, ai ka lëvizur lehtësisht nëpër fshat.



Gjatë përcjelljes së familjes Zykaj për në banesën e fundit

SHËNDETI MENDOR

Prokurori ka kërkuar ekspertizë mjekësore për të vërtetuar nëse Ridvan Zykaj ka probleme mendore. Ndërkohë, policia thotë se autori nuk ka pasur kartelë mjekësore. Nga ana tjetër, bashkëfshatarët shprehen se më herët ai ka qenë i shtruar në spitalin psikiatrik.

SI NDODHI NGJARJA

I kanë mjaftuar vetëm 5 minuta dhe 30 metra distancë që 24-vjeçari Ridvan Zykaj të shuajë tri familje. Me kallashnikov në dorë, ai ka hyrë fillimisht në banesën e Besim Zykajt, të cilin e ka gjetur në shkallët e banesës ku dhe e ka vrrarë e më pas bashkëshorten e

tij. Por duket se nuk është mjaftuar me kaq, pasi ai ka qëlluar pa mëshirë edhe mbi dy kushërinjtë e tij, Sarën, 15 vjeçe dhe vëllain e saj, Ledjonin, vetëm 8 vjeç. Më tej vrasësi është drejtuar tek shtëpia e vëllait tjetër, Azemit, ku e ka lënë të vdekur në vend atë të bashku me bashkëshorten. Destina-

cioni i fundit për 24-vjeçarin ka qenë banesa e Demirit, babai i dy viktimave. Ridvani mësohet se ka qëlluar në drejtim të Demirit, i cili qëndronte në divan në ballkonin e shtëpisë dhe më pas ka shënë në drejtim të gruas së tij, duke e lënë dhe atë të vdekur në vend. Viktimat kanë pasur plagë të shumta nga plumbat e kallashnikovit, kryesisht në bust dhe në kokë. Afërdita Zykaj është goditur nga 6 plumba. Azemi Zykaj është goditur me 4 plumba dhe të katërt i ka në kokë. Djali i vogël Ledjoni është goditur nga tre plumba, ndërsa vajza, Sara 16 vjeçe është goditur 4 plumba.



Ceremonia e djeshme mortore në fshatin Resulaj

Adoleshenti i shpëton masakrës

Albi Zykaj humb të gjithë familjen

Albi Zykaj është vetëm 17 vjeç edhe ditën e djeshme ka përcjellë për në banesën e fundit babain, nënën, motrën e vëllain e mitur. Fatmirësisht adoleshenti nuk ndodhej në banesë gjatë kohës që ndodhi tragjedia, pasi punonte në bregdet. Po ashtu, dora gjakatare e Ridvan Zykajt i mori edhe gjyshërit e tij, Demirin dhe Ferien; xhaxhain Azemin bashkë me gruan e tij Afërdita. Vetëm 17 vjeç do t'i duhet të përballet me vështirësitë e një jetimi të shkaktuar nga dora kriminale e kushërinjtë të tij. I mundur nga lotët dhe dhimbja, Albi ka tentuar të flasë edhe para mediave, por e ka pasur të pamundur. Adoleshenti ka qenë duke punuar në bregdet, kur është njoftuar nga të afërmit e tjerë për tragjedinë që i kishte ndodhur familjes së tij. Po ashtu, mes familjarëve që i mbijetuan masakrës ishin edhe dy djemtë e Azemit, që ndodheshin në emigrim në momentin e ngjarjes së rëndë.



Kësaj masakre kanë mundur t'i shpëtojnë vetëm tre djem të familjes Zykaj, të cilët nuk ndodheshin në shtëpi. Nga familja e Besimit ka shpëtu-

ar vetëm një djalë, Albi Zykaj (punonte në një restorant në Vlorë), ndërsa nga familja e Azemit dy djem, njëri nga të cilët ndodhet në Greqi.



FLET GJYSHI I AUTORIT

"SI I GJETA TRUPAT E NIPËRVE"

Gjyshi i autorit të masakrës mes dhimbjes që po përjeton edhe për humbjen e vëllait të tij, ka gjetur forcë për të treguar sesi i gjeti trupat e pajetë të vëllait të tij e më pas nipërve. "Ishim në drekë, në atë festë ai piu një birrë dhe një tjetër e mori me vete. Si plak që jam, unë u ngrita nga tavolina më shpejt, pas meje u ngrit edhe ai. I thashë ç'do do bësh, më tha do nxjerr dhentë - tregon gjyshi. Pashë një vëlla të shtrirë me kokë poshtë i vrrarë, e mora. Mora dhe kунатën, e ujdisa. Më pas pashë nusen e vrrarë të Azemit. Kur shkova pastaj andej tek nipi i vogël, oj nene. Ajo ishte kujë e zezë".



KUSH ËSHTË RIDVAN ZYKAJ

HAJDUTI I PULAVE, QË U SHNDËRRUA NË VRASËS

24-vjeçari, një djalë i thjeshtë fshati, i cili nga hajdut pulash, u shndërrua në një vrasës gjakftohtë. Fqinjët tregojnë se 7-8 vite më parë kishte pësuar djegie trupi dhe se jetonte me prindërit, të vëllanë dhe të motrën. Për forcat blu të zonës, ai njihet si një hajdut i rëndomtë, shumë larg profilit të një vrasësi. Që pas djegies së tij, bashkëshatarët tregojnë se Ridvani ndryshoi totalisht sjellje.



Janë dashur rreth 12 orë nga ngjarja e rëndë në Resulaj të Selenicës që të vihej në pranga autori. Rreth 500 forca policie u angazhuan për të kapur Ridvan Zykajn, i cili u gjend rreth 2 kilometra larg shtëpisë së tij. Autori i masakrës së Selenicës ka dhënë dëshminë e parë para forcave të rendit. Me tone ironike, 24-vjeçari ka thënë përpara policisë se ishin vonuar shumë në arrestimin e tij. Më tej, ai nuk ka shfaqur shenja pendese për ngjarjen e rëndë. Ritvan Zyka është shprehur se ishte i pirë dhe nuk mbante mend çfarë kishte ndodhur. I pyetur për shkaqet e ngjarjes tragjike, ai shprehet se kushërinjtë e tij e akuzonin për çdo gjë të keqe që u ndodhte. "Ata më akuzonin mua për çdo gjë që u ndodhte. Nuk mbaj mend gjë, kam qenë i pirë", është shprehur ai ndër të tjera. Ndërkohë, pas testit të bërë sot fill pas e arrestuan, në gjakun e tij nuk janë konstatuar sasi të mëdha alkooli, çka e rrëzon pretendimin se ishte i dehur. I trembur, duket se autori ka kërkuar edhe një avokat, nga frika se mos e vrisnin. "Dua avokat që të mos më vrisni" mësohet të ketë thënë para grupit hetimor 24-vjeçari, duke pranuar autorësinë e vrasjes së 8 familjarëve të fisit të tij, mes tyre 3 gra dhe dy fëmijë. "Grupi hetimor me ekspertë të Policisë Kriminale të DVP Vlorë dhe të Departamentit të Policisë Kriminale në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë po vijojnë hetimet lidhur me motivin e plotë të kriminit të kryer prej 24-vjeçarit në fshatin Resulaj", deklaroi policia e Vlorës. Që prej momentit që u shoqërua në ambientet e DVP Vlorë, autori po pyetet në disa seanca nga strukturat policore përkatëse mbi rrethanat e kriminit. Policia deklaroi se nga hetimet e deritanishme dhe nga deklaratimet paraprake të shprehura prej tij ka rezultuar se e ka kryer aktin kriminal për motive të dobëta/banale, (autori është shprehur se pjesëtarë nga dy familjet Zyka e kanë akuzuar për vjedhje). Lidhur mbi këtë, por edhe në pista të tjera policia po vijon hetime të imtësishtme deri në zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes".

Masakra në Selenicë, autori sfidon policinë: Më arrestuat vonë

Dëshmia e 24-vjeçarit: I vrava se më quanin hajdut

Ridvan Zyka u arrestua vetëm 2 km larg shtëpisë



Autori i masakrës, Ridvan Zyka

12 orë kërkime dhe 500 trupa të angazhuar

Si u arrestua Ridvan Zyka, operacioni i drejtuar nga Ardi Veliu

Ridvan Zyka, autori i masakrës me 8 të vdekur në Selenicë të Vlorës u kap nga policia në orët e para të ditës së sotme. I gjakosur në fytyrë dhe i lodhur, Zyka nuk ka folur fare në momentin e arrestimit. Ai u ndoq gjatë gjithë natës nga Forcat Speciale duke bërë të mundur kapjen në periferi të fshatit si edhe sekuestrimin e armës së kriminit. Burime zyrtare bëjnë me dije se operacioni është drejtuar dhe koordinuar nga Drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu, i cili ka qenë edhe vetë në terren. Forcat e policisë ishin të reparteve FNSH, Delta, RENE, poli-



cia e Vlorës, Orikumit, stacioni i Selenicës, Policia e Shtetit etj. Mësohet se gjatë operacionit janë përdorur kamera termike, dylbi nate, dylbi dite dhe qen gjurmimi. Po kështu, nga ana e drejtuesve të operacionit janë porositur komandantët e grupeve që të bëjnë kujdes sepse autori ishte i armatosur. Policia ka për-

duror edhe metoda përgjimi, por autori e ka mbyllur telefonin pas orës 23:30. Burimet thanë se kontrolli është bërë me dy skalione. Një grup ka qenë me perimetër të gjerë, shumë larg vendit të ngjarjes dhe grupi i dytë ka nisur kontrollin nga shtëpia ku ndodhi ngjarja drejt grupit tjetër, duke formuar kështu një rreth dhe më pas duke e mbyllur deri në kapjen e tij. Ridvan Zyka është konstatuar me dylbi të ditës rreth orës 5 të mëngjesit. Nga policia i është bërë thirrje, "Dorëzohu, hidh armën" dhe nuk ka pasur rezistencë nga ana e 24-vjeçarit.

na të ngjarjes", thuhet në njoftimin e policisë. Burime pranë uniformave blu kanë bërë të ditur se Zyka është pikasur në momentin që po dilte nga një shkurre. 24-vjeçari kur ka parë policinë,

ka tentuar të rrëmbejë automatikun që kishte me vete, por uniformat blu i kanë kërkuar që të dorëzohet dhe të hidhte armën. Ai nuk ka bërë rezistencë, ndërsa është shfaqur krejt i qetë, ndër-

sa ka kërkuar të pijë ujë. Forcat e policisë lokale, RENE dhe FNSH fill pas ngjarjes rrethanat fshatin për kapjen e autorit, i cili u largua nga vendi i ngjarjes pak pasi ekzekutoi me kallash-



MEDIAT E HUAJA PASQYRONJË NGJARJEN

Mediat e huaja, italiane, greke dhe angleze kanë pasqyruar masakrën e së premtes në Selenicë, ku 24-vjeçari Ridvan Zyka ekzekutoi me kallashnikov tetë familjarë të një motive banale. Vrasja e tetëfishit e dy ditëve më parë në Resulaj të Selenicës ka bërë bujë edhe në mediat e huaja, për shkak të përmasave tragjike të saj dhe numrit të lartë të viktimave.

SHQIPTARËT SHAJNË E MALLKONJË AUTORIN

Mjaft e ndjeshme ka qenë kjo ngjarje për mbarë opinionion publik. Në rrjetet sociale të shumtë kanë qenë ata që kanë sharë dhe mallkuar autorin e masakrës. Nuk kishte ndodhur kurrë që ndërsa autori ndiqej nga policia me të gjitha mjetet e saj, të kthenetë përgjigje në profilin e tij në "Facebook".

nikov të afërmit e tij. Ndërkaq, bëhet me dije se 24-vjeçari është shoqëruar edhe pak kohë më parë në polici, pasi ka qëlluar me armë në ajër, por është liru- ar disa orë më pas.

24-vjeçari, mesazh Ramës

Ritvan Zyka, autori i masakrës në Vlorë, ku mbetën të vrrarë tetë persona ka pasur kohë gjatë momenteve që ka qenë në arrati të bëjë komente në rrjetet sociale. Zyka e kaloi kohën në arrati duke bërë komente në rrjetet sociale. Nën një prej komenteve ai "sfidon", kryeministrin Edi Rama duke i thënë: "O Edi Rama, a më gjen dot ku jam?"

Ridvan Zyka "kukafshehti" me Xhafajn

Duket se në orët e gjata të arratisë, autori i ngjarjes së rëndë të ndodhur pasditen e premte në Selenicë ka gjetur kohë të ironizojë edhe ministrin e Brendshëm. Pasi ka shkëmbyer komente dhe ka shkruar një status për Ramën, ai i ka drejtuar një status edhe ministrit. "Duke pritur Fatmir Xhafajn". Ka shkruar 24-vjeçari në adresën e tij në "Facebook".

MASAKRA E SELENICES

REAGIMET

Vrasjet në Selenicë/ Opozita sulmon kryeministrin, PS bën propozime

Berisha, Ramës: Turp, nuk reagojnë për vrasjet. Ndreu: Duhet solidaritet

Spiropali: Fushatë publike për mbledhjen e armëve, dënim autorit

Masakra e Selenicës ka ngjallur reagime të ndryshme të deputetëve të opozitës dhe maxhorancës. PD dhe LSI kanë kritikuar mosreagimin e kryeministrit Edi Rama, ndërsa Partia Socialiste ka dhënë propozimet e para për rrugët që duhen ndjekur në të ardhmen për të shmangur tragjedi të tilla. Ish-kryeministri Sali Berisha shkroi dje në rrjetin social "Facebook": "Një masakër që tronditi Shqipërinë dhe bëri lajm botëror, por nuk të preku ty o skizofren! Një mijë herë turp o faqezi antishqiptar dhe antinjeri!". "Kjo masakër makabre ka përbërë një lajm botëror në të gjitha mediat e mëdha të botës. Por kjo masakër nuk ka përbërë lajm, nuk është dënuar dhe nuk u është thënë një fjalë ngushëlluese familjarëve nga monstra në krye të qeverisë dhe fundërrinat e tjera të kabinetit të skizofrenit, i cili me heshijen e tij paranojake i vrau për së dyti viktimat e Selenicës! Me këtë rast dua t'i them monstrës në krye të qeverisë, njëjind e një mijë herë turp o faqezi, antishqiptar dhe antinjeri, ty dhe fundërrinave që të rrethojnë", u shpreh Berisha, duke iu drejtuar kryeministrit Rama. Po i ashpër ishte edhe nënkryetari i PD-së, Edi Paloka. Ai tha se ngjarja ka tronditur qdo shqiptar, por i vetmi që jeton në botë tjetër është kryeministri Edi Rama, duke kujtuar përhëndetjen e tij të mëngjesit. "I vetmi që vazhdon të jetojë në botë tjetër është kryeministri i vendit. Pikërisht në këto momente dhe pikërisht nga Vlora, Rama shkruan në 'FB': 'Ju uroj një fundjavë të qetë'... Është cinizimi ekstrem i një kryeministri që nuk ja ndjen", tha dje Paloka. Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili iu është bashkuar reagimeve për masakrën që ndodhi dje në Resulaj, ku 8 pjesëtarë të një tringje familjar u vranë nga kushëriri i tyre. Përmes një statusi në "Facebook" Vasili i është "sulur" kryeministrit Edi Rama, ndërsa shkruan se i marrë për qesh mortin'. Vasili shton se: "I marrë në krye të qeverisë gjënjën me ca idiotë-sira shifrash punësimi të rreme edhe për ditë zie".

SOCIALISTËT
Ndërkohë, nënkryetaria e grupit parlamentar të PS-së, deputetja Elisa Spiropali ka bërë thirrje për një fushatë publike për mbledhjen e armëve. Në një reagim pas



Ish-kryeministri, Sali Berisha

Deputeti socialist, Erjon Braçe, bën thirrje që të nisë një aksion çarmatimi, pas masakrës së djeshme në Selenicës, ku 8 persona u vranë nga 24-vjeçari Ritvan Zyka. Braçe sjellë në vëmendje apelin e ish-kryeministrit Sali Berisha, i cili në prill të vitit 2016 bënte thirrje për armatosje të popullsisë nga foltorja e parlamentit, duke vlerësuar se situata ishte e pasigurt. Braçe u shpreh se Berisha, arritjen e qëllimit dhe imponimin e zgjidhjeve e bën përmes armëve. Ndërkohë, një apel i bën edhe Lulzim Basha, kryetari i PD-së: "Lulëzim ndaj mendjen, je me armën si ky këtu, apo kundër saj si pjesa më e

ngjarjes së rëndë në Selenicë ku u vranë 8 persona të një familjeje, Spiropali kërkon një ligj të posaçëm për ata që mbajnë armë pa leje si dhe dënim maksimal për vrasësit. "Fushatë publike për mbledhjen e armëve. Ligj i posaçëm me dënim të rëndë për ata që zotërojnë armë pa leje. Dënim maksimi

Deputeti si PS: Lulzim je me armën si Berisha, apo kundër?

Erion Braçe: Të zhbëjmë kulturën e armës, le të mbushen burgjet plot

madhe e shqiptarëve!", shkroi dje Braçe. Duke e cilësuar vrasjen e 8 personave në Selenicë një dramë, Braçe u shpreh: "Prej vitit 1997, ato janë makabre dhe shumë të dhimbshme. Kurrë, po kurrë s'u ndal kush të analizojë, marrë përgjegjësi e vendosë. Të tregojë rrugën se si ky vend çarmatoset. Ka ardhur koha që ne të zhbëjmë kulturën e armës, komunikimin përmes saj, zgjidhjet duke përdorur armët. Është e vështirë, e di. Ka njerëz si ky që e

shpreh: "Ngjarja e rëndë e Selenicës nuk është arsye për të zbratur të gjithë arsenalin e padijes duke akuzuar Edi Ramën, qeverisjen, të etiketosh shoqërinë primitive, të gesh policinë e paaftë etj. Të tilla raste dhe më rëndë kanë ndodhë e ndodhin qdo ditë gjithkund. Mabajta në kontroll e krimin nuk është fjalë

Rama publikon shifrat për ekonominë, komentuesit i shkruajnë: Po shtohen vrasjet

Kryeministri Rama e ka nisur ditën dje duke postuar në "Facebook" një video ku jepet informacion mbi ecurinë ekonomike në vend, punësimin dhe bizneset e reja në vend. "Mirënjohje si dhe me këtë videoinformacion për ecurinë ekonomike, punësimin dhe bizneset e reja në vend, ju uroj një fundjavë të qetë", - shkruan Rama, duke vënë në dukje parashikimin për rritjen ekonomike 4.45% në vitin 2018, krahasuar me vitin 2013. Kaq ka mjaftuar që komentuesit të shpërthejnë në revoltë, duke replikuar ashpër ndaj kreut të qeverisë në postimet e tyre. Njëkësit shkruajnë se vrasjet po shënohen përditë nga veriu në jug, ndërsa sa i takon masakrës, ata i kërkojnë kryeministrit se dita e sotme duhet shpallur ditë zie.



AGRON SHEHAJ
Deputeti demokrat i Vlorës, Agron Shehaj ngushëlloi dje përmes një postimi në "Facebook" familjarët e viktimave të Selenicës. Ai bëri thirrje të rrisim besimin në Zot. "Mjerë të gjithë ata që mendojnë se mund të jetojnë në një shoqëri pa Zot dhe pa moral", tha Shehaj.

Basha ngushëllon familjarët e viktimave: Reflektimi për pasigurinë shtohet çdo ditë

Kryetari i PD, Lulzim Basha ka shprehur dhimbjen e tij për ngjarjen tragjike të Selenicës, ku u masakruan 8 anëtarë të familjes Zyka. Basha ngushëlloi familjarët e viktimave dhe shtoi se kjo është një ditë reflektimi për pasigurinë që shtohet çdo ditë në Shqipëri. "Vrasja mizore e 8 familjarëve në Resulaj, përfshirë 2 fëmijë, ka tronditur të madh e të vogël. Mendimet dhe lutjet e mia janë për shpirtat e të ndjerëve dhe dhimbjen e të afërmeve. Sot është ditë zie për Vlorën dhe vendin, por edhe reflektimi për pasigurinë që shtohet çdo ditë", tha dje kreu i PD-së, Lulzim Basha.



kanë zgjatim armën, por duhet të vendosim tani, duke ashpëruar ligjin, zbatuar pa asnjë dallim kudo, në rrugë,

shtëpi, makinë, brez për cilindo të marrë apo të përgjegjshëm të unifikojmë politikën penale kundër tyre, secilit prej tyre. Pa mëshirë! Le të mbushen burgjet plot me këta, ama do pastrohen rrugët, lagjet, shtëpitë, baret e restorantet, plazhet nga soji i këtyre që rrëmbejnë një status prej armës, komunikojnë me armë, zgjidhin hatrin apo hallin, hakun apo gjakun sipas gjuhës se tyre, me armë", u shpreh Braçe.


goje, as fantazi pa lidhje gazetarësh e politikanësh. Por është lojë e vështirë për ata që e kanë provuar në SHBA, Gjermani, Britani, Francë e kudo. Ju them juve që shkruani që keni të drejtë të kërkonit qeveri më të mirë, ekonomi më të shëndoshë, shoqëri më solidare, por nga ngjarjet të tilla s'keni për të

shpëtuar sa të jeni gjallë. Është e lehtë të shkruash ç'të vjen në mend për fajtorë që i ndodh krimi. Më shumë vlejnjë mesazhet për solidaritet në luftë kundër krimin, që është një fenomen që i kërkon në një vijë të gjithë pa dallim partie e jo njëri thumbit e tjetri patkoit!", u shpreh Ndreu.



DIALOGU VAZHDON

Sidoqoftë Serbia dhe Kosova do ta vazhdojnë dialogun e nivelit të lartë politik në fillim të shtatorit me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Një marrëveshje e detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë po kërkohet me ngulm nga BE-ja.



Ish-ministri serb paralajmëron "Shqipërinë e Madhe"

Jeremić: Nëse ndryshohen kufijtë, Kosova bashkohet me Shqipërinë

Kryetari i Partisë Popullore të Serbisë, Vuk Jeremić deklaroi se nëse ndryshohen kufijtë, Kosova do të bashkohet me Shqipërinë. Në një prononcim për mediat serbe, ish-ministri i Jashtëm serb tha se përcaktimi i vijës kufitare me Kosovën, për të cilin po angazhohet presidenti serb, Aleksandar Vučić paraqet një riefinim të kufijve. "Kjo parqet një tjetërsim të përhershëm dhe me paramendim të një pjese të territorit të Serbisë. Përcaktimi i kufijve paraqet Kosovën si anëtare e OKB-së brenda gjashtë muajve, kurse brenda pak vitesh, 'Shqipërinë e Madhe'. Një nënshkrim ndryshon gjithçka", tha ai. Po ashtu, Jeremić komentoj edhe deklaratën e Vučić për demarkacionin e kufirit me Kosovën, ndërsa tha para gazetarëve se "demarkacioni është jokushtetues dhe thellësisht i dëmshëm dhe përbën një diktaturë të përsheptuar, e cila vjen nga fazhizmi në Serbi".

Kufiri Kosovë-Serbi, Vuçiç: Territori i përbashkët, burim konfliktesh

Mediu: Shqiptarët, më në rrezik se ndonjëherë në historinë e pasviteve '90

Shehu: Nesër do t'i zhdukim kufijtë duke qenë të gjithë në BE

E ardhmja e Ballkanit Perëndimor është Bashkimi Evropian, ndaj sipas ish-ministrit të Jashtëm, Tritan Shehu, tezat për korrigjim apo ndryshim kufijsh nuk flasin për të ardhmen, por për të shkuarën. "Në jemi për t'i zhvendësuar kufijtë në rajon në këto momente, duke implementuar ligjet e rregullat e BE-së. Nesër do t'i zhdukim kufijtë duke qenë të gjithë në BE", tha Shehu dje në një prononcim për "Top Channel". Teza e Thaçit, e cila gjithsesi nënkupton ndryshimin e hartës së shtetit të pavarur të Kosovës, do të ishte kundërvënë ndaj partnerëve evropianë e amerikanë, që u investuan për këtë shtet. "Kjo do të thotë që të transmetosh mesazhin që 'Ju e kemi bërë gabim', e tani duhet hapur sërish kutia. Hapja e kutisë është shumë e gjerë, asnjë nuk e di sesi do të shkojë dhe ku do të çojë. Në qoftë se dikush mendon që Serbia është bërë një lloq i butë, që mund të japë çdo gjë, gabon rëndë. Pas Serbisë fshihen të tjera fuqi të interesuara të vonojnë procesin e integritetit të Ballkanit në BE, apo të rikrijojnë reminishencat e tyre të vjetra, tha më tej Shehu. Rusia dhe Turqia, sipas ish-ministrit të Mbrojtjes, Fatmir Mediu po shtojnë ndikimin në Ballkan, që nuk është më në vëmendjen e BE-së apo SHBA-ve si më parë, kur Shqipëria u anëtarësua në NATO apo Kosova fitoi Pavarësinë. "Do të thosha që shqiptarët janë sot në një situatë më të rrezikshme të mundshme, që kanë qenë ndonjëherë në historinë e pas viteve '90, apo pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës", tha Mediu për "TCH".



Ish-ministri i Mbrojtjes, Fatmir Mediu

GREG DELAWIE

"Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë nga miqtë më të afërt dhe mbështetës të Kosovës, pavarësisht atë që mund të lexoni në media, kjo nuk ka ndryshuar dhe nuk do të ndryshojë. Partneriteti ndërmjet dy vendeve është i thellë dhe shumëdimensional", tha ambasadori amerikan në Kosovë, Delawie.

tinë për ndarje të Kosovës. Madje, presidenti Vuçiç tha se ai e promovon politikën për ndarje me shqiptarët. Në Kosovë, presidenti Hashim Thaçi nga ana tjetër thotë se, "nuk ka ndarje tokësore të Kosovës", por kërkim korrigjim të kufirit që sipas tij nënkupton bashkimin me Kosovën të tri komunave me shumicë sh-

qiptare të jugut të Serbisë. "Unë jam në favor dhe kjo është politika ime, për ndarjen me shqiptarët, sepse të kemi një territor që nuk dihet se kush e trajton atë dhe çfarë kujt i përket është gjithmonë një burim konfliktesh të mundshme. Nuk e fsheh një syhim të tillë, por nuk dihet nëse këtë do ta pranojë populli serb

apo jo dhe nëse do të ketë sukses, kjo nuk varet vetëm nga Serbia", tha Aleksandër Vuçiç. Mediat në Prishtinë citojnë edhe Ambasadën Gjermanisë në Kosovë, ku thuhet: "Gjermania është kundër ndryshimit të kufijve. Ministri i shtetit gjerman, Michael Roth, sikurse edhe ambasadori Christian Heldt në intervista të ndryshme e kanë bërë të qartë pozicionin zyrtar lidhur me dialogun për normalizim të marrëdhënieve". E përditshma kosovare "Koha Ditore" citon pjesë të një interviste të ministrit Roth, dhënë kësaj gazete në 10- vjetorin e pavarësisë, i cili thotë se "lëvizjet e kufijve janë shumë të rrezikshme dhe mund ta destabilizojnë të gjithë rajonin e Ballkanit". "Unë nuk do t'i ofroja asnjëherë palë propozime konkrete nga jashtë, sepse çështjet që ju përmendni janë shumë komplekse dhe sigurisht, aspak të thjeshta për t'i zgjidhur. Mirëpo, përgjithësisht unë kam besim që Kosova dhe Serbia do të tejkalojnë këtë pengesë, nëse për këtë ka vullnet politik. Ndonëse këtu më duhet të shpreh një paralajmërim: lëvizjet e kufijve janë tejet të rrezikshme. Ne i kundërshtojmë ato në mënyrë kategorike", citohet të ketë thënë ministri Michael Roth.

Reagimi pas ndalimit të ish-kryetarit të Akademisë së Shkencave

Ministria e Jashtëme e Kosovës: Serbia të mos pengojë lëvizjen e lirë të qytetarëve

Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës përsëriti se ndalimi për herë të dytë brenda pak ditësh i ish-kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe anëtarit të Akademisë Evropiane të Shkencave dhe Arteve, z. Hivzi Islami, që të hyjë në shtetin fqinj dhe të vizitojë familjarët e tij, si edhe shumë raste të tjera pothuajse të zakonshme si për zyrtarët e lartë, ashtu edhe për qytetarët e zakonshëm janë në kundërshtim të plotë me Marrëveshjen e Brukselit, zotim deklarativ të shtetit fqinj Serbisë për normalizimin e



fqinj që të ndërpresin menjëherë veprimet dhe sjelljet e tilla ndaj shtetasve të Republikës së Kosovës dhe paralelisht me këtë edhe përfaqësuesit e BE-së që të dalin në mbrojtje të njërit prej parimeve themelore, në bazë të së cilit është themeluar edhe vetë BE-ja. Ministria e Punëve të Jashtme do të përcjellë me vëmendje të posaçme rastet e ngjashme në të ardhmen, rishqyrtojë qasjen pozitive ndaj kërkesave për vizita nga autoritetet e Serbisë në Kosovë dhe do të veprojë në bazë të parimit të reciprocitetit, nëse raste si ky përsëriten në vazhdimësi dhe janë me qëllim të keq.

SHPLLJJE ANKANDI
Datë 17.08.2018, Ora 16:00

Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Agron Shefqet Burhani dhe dorëzueses Hatibe Shefqet Burhani:
"Apartment barim - Trust" me sipërfaqe 62 m2, nr. pasurisë 14301, zona kadestrale 3574 e regjistruar në regjistrin hipotekor numër 2561 datë 07.10.1994, adresa: Lajga "15 Shtatori", pallati 53, shikalla 1, apartamenti 4, Topelë.
Çmimi fillues i ankandit të parë është në shumën 1.280.000 (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekë.
Ankand do t'zhvillohet, ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.

PRESIDENTI SERB
Ndërkohë dje "Deutch Welle" shkruante se Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç po angazhohet tashmë hapur për ndarjen ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë, duke nxitur edhe më shumë debatin në Beograd dhe Prish-

Sizmologët: U ndje në disa shtete në Ballkan, lëkundja e 932-të brenda 1 muaji

Tërmeti 5.1 ballë lëkund disa qytete të vendit, dëmtohen rreth 70 banesa në Dibër

Ministria e Mbrojtjes bën bilancin: Dëme të pjesshme të shtëpive


Rikthehen tërmetet në vendin tonë. Lëkundje të forta sizmike u ndjenë pasditën e djeshme në Tiranë dhe disa qytete të tjera të vendit. Sipas IG-UEM dhe Institutit Europian të Sizmologjisë, tërmeti ka qenë me magnitudë 5.1 ballë i shkallës rihter. Lëkundjet janë regjistruar rreth orës 17:38 të kësaj pasditeje. Epiqendra e tërmetit ka qenë 10 km në veri të Bulqizës në një thellësi prej 25 km. Lëkundjet janë ndjerë më të forta në qytetet si Peshkopi, Burrel, Laç, Pukë, Elbasan si dhe Librazhd. Gjithashtu, lëkundjet raportohen se janë ndjerë edhe në Maqedoni, Kosovë e Mal të Zi. Nga informacionet nuk u raportua për të lënduar, ndërsa në Dibër janë dëmtuar disa banesa. Përmes një njoftimi, Ministria e Mbrojtjes ka nxjerrë bilancin e shtëpive të dëmtuara në secilin qark, ndërsa shiton se specialistët e Emergjencave Civile ndodhen në zonë edhe për t'u ardhur në ndihmë banorëve. "Sot, (dje) më datë 11.08.2018, ora 17:33, në fshatin Vinjoll të Bashkisë Mat ka pasur një lëkundje tërmeti me magnitudë = 5,4 shkalla rihter dhe thellësi = 5 km. Lëkundjet e tërmetit janë ndier në qarqet Shkodër, Lezhë, Dibër, Kukës, Tiranë dhe Elbasan. Deri tani nga komunikimi i QKOE me specialistët e Emergjencave Civile në Prefekturën Dibër janë raportuar këto dëmtime të pjesshme në banesa: 12 banesa të dëmtuara në Bashkinë Klos, kryesisht në qarje muresh, dëmtime tav-



anesh etj. 8 banesa të dëmtuara në Bashkinë Mat si dhe 47 banesa të dëmtuara në Bashkinë Bulqizë, qarje muresh". "Specialistët e Emergjencave Civile në bashkitë të cilat kanë pasur problematika në lidhje me lëkundjet e tërmetit janë në terren së bashku me punonjës të tjerë të bashkive për t'u ardhur në ndihmë banorëve. Specialistët e Emergjencave Civile në Prefekturën Dibër janë në

komunikim të vazhdueshëm me forcat që ndodhen në terren për të bashkërenduar veprimet, në mënyrë që mos të ketë probleme tek banorët e prekur nga lëkundjet e tërmetit", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Mbrojtjes. Tërmeti i dytë Një tërmet tjetër më i ulët ka lëkundur Shqipërinë pak minuta më vonë. Tërmeti ka pasur një magnitudë prej 3.1 ballësh. Zakonisht, lëkund-

jetë tilla quhen pastërmete. Tërmeti ka ndodhur në thellësi rreth 2 km, me një distancë 78 km në verilindje të Tiranës dhe 19 km në jugperëndim të Kukësit. Tërmeti është regjistruar në orën 18:40 minuta. Sizmologu Olgert Gjuzi në një intervistë për "Ora News" tha se tërmeti më i fuqishëm u regjistrua në afërsi të Bulqizës me magnitudë prej 5.1 rihter. Sipas tij, lëkundja është shoqëruar edhe me 15 lëkundje të tjera më të ulëta dhe kjo është një shenjë e mirë, se mund të mos ketë më lëkundje të forta. Nga raportimet, pothuajse e gjithë Shqipëria është prekur nga ky tërmet. Nga raportimet "online" të qendrës sizmologjike për Evropën dhe Mesdheun ka raportime pothuajse në të gjithë rajonin. Sizmologët thonë se kjo ishte lëkundja e 932-të brenda 1 muaji. Tërmetet vijojnë të shkaktojnë panik tek qytetarët. Ky është tërmeti i dytë që godet vendin tonë me të njëjtën magnitudë prej 5.1 ballë i shkallës rihter, pas atij të datës 4 korrik me epiqendrë në Gjirin e Lalzit, në Durrës.



Furtunë në Kuçovë, rufeja godet 60- vjeçarin sapo del nga kafja, qyteti pa energji

Një 60-vjeçar nga Kuçova është goditur nga rufeja sapo ka dalë nga një lokal ku ka konsumuar kafe. Bilbil Asllani banues në lagjen "Tafil Skëndo" të Kuçovës, po kthehej në shtëpi kur u godit nga rufeja në qendër të qytetit. Ai është në gjendje të rëndë në Spitalin Rajonal të Beratit, ku është dërguar me ambulancë. Moti i keq me furtunë ka goditur Kuçovën në orët e pasdites duke lënë qytetin rreth 1 orë pa energji elektrike. "Më datë 11.08.2018 rreth orës 20:00, është marrë njoftim se pranë një lokali në Kuçovë, një rufe ka goditur shtetasin B.A., 60 vjeç, banues në lagjen "Tafil Skëndo", Kuçovë. Për pasojë shtetasi i lartpërmendur ka marrë lëndime dhe është transportuar në Spitalin Rajonal Berat për ndihmën e nevojshme mjekësore, i cili për momentin ndodhet jashtë rrezikut për jetën", thuhet në njoftimin e policisë.

Shkëputet masivi shkëmbor në Valbonë pas tërmetit, godet makinën me 4 udhëtarë

Lëkundjet e forta të tërmetit pasditën e sotme që shkundën të gjithë vendin dhe jo vetëm, kanë pasur pasojat e veta. Një masiv shkëmbor është shkëputur në zonën e Valbonës, duke goditur një automjet. Nga raportimet e para thuhet se masivi shkëmbor u shkëput nga lëkundjet e tërmetit. Ngjarja ndodhi në aksin Valbonë-Bajram Curri. Katër shtetas kosovarë u goditën nga masivi shkëmbor teksa udhëtonin me një mjet "Land Rover". Mjeti u godit në pjesën e bagazhit dhe



bëri 3-4 rrotullime, por për fat të mirë, 4 shtetasit kosovarë, 2 burra e 2 gra, janë

jashtë rrezikut për jetën. Ata u transportuan menjëherë në Kosovë.

Deputetja e PD: Dhjetëra banesa të dëmtuara në Dibër, shteti të ndërhyjë

Deputetja e Dibrës, Dhuçata Çupi u shpreh dje se qarkun e Dibrës ka dhjetëra banesa të dëmtuara nga tërmeti dhe kërkon "ndihmë urgjente" nga autoritetet shtetërore. "Në qarkun e Dibrës paraqitet shqetësues dhe me pasojë, situata pas tërmetit, epiqendra e të cilit ishte në Mat. Nga komunikimet e mia të vazhdueshme banorët, të shqetësuar ata tregojnë se nga tërmeti kanë mbetur shumë banesa të dëmtuara, ndërsa vetë janë të trembur e disa edhe në qiell të hapur. Ka dëme në dhjetëra banesa në Bashkitë Klos, Mat e Bulqizë. Kjo situatë kërkon angazhimin urgjent të autoriteteve ligjzbatuese për t'u ardhur në ndihmë banorëve. Nga komunikimin me institucionin e Prefektit



dhe me organet e njësive vendore përgjegjëse, kërkoja që strukturat e këtyre institucioneve duhet të angazhohen në këtë situatë, që të evidento-

tohet çdo banesë apo familje që ka nevojë për strehim apo mbështetje", shprehet deputetja demokratike në një reagim në rrjetet sociale.

Shitje me Ankand të Pare nga Studio Permbarimore L.D.C

"Ndertese", me sipërfaqe 600 m², me Nr. Pasurie 495/15, Vol 5, fq.83, ndodhur në ZK 3426 me adresë në Tulinë, Tiranë. Regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë në emër të Zyber KUKA. Çmimi fillestar për shitje është 3.360.000 Leka.

Data e shpalljes 01.08.2018
Data e zhvillimit 24.08.2018 deri në orën 16.00
 Ankandi zhvillohet në ambientet e Studios Permbarimore L.D.C me adresë Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tiranë.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 Zyra permbarimore "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë **06 shtator 2018 nga ora.08.00-ora.16.00** tek kjo zyra përmbartore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin i l-rë, për shitjen e a) nr.pasurie 26/106+1-26, vol 52, fq 1, ZK 8603, me çmim fillestar **4725000 lek**; b) nr.pasurie 26/187-ND, vol 52, fq.28, me çmim fillestar **35938000 lek**.

Të dyja prona ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petro Marku", Vlorë) që ka ndërtuar Debitori "CO.BE.IN" - shpk (NUIJ J97201218L)

Për sqarime të mëtejshme kontaktoni në tel: **052226000** ose cel: **0692075 644**

Permbartuesi gjyqësorë Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë:

Tiual+Ndertese e regjistruar në regjistrimin hipotekore me nr pasurie 9/268 në ZK nr 8592, me nr prone 47, me sipërfaqe totale 161 m², nga kjo 66 m² ndertese me adresë I partizani në Shkodër

2. Çmimi më i ulët do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërshkruar, është në vlerën 2,016,000 (Dy milionë e gjashtëmbëdhjetë mijë) Lekë.

Shitja e pasurisë do të behet (zhvillohet) me date **15.08.2018 ora 16:16** në Zyren e permbaruesit gjyqësorë **Genti Bushati** me adresë Rruga Don Bosko, Perballë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkodër. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10% të vlerës si garanci në Bankën BKT dhe Shkodër me nr llogarie 41064051.

Kërkohen inxhinierë, ekonomistë, rrobaqepës, prestarë, fadromistë etj.

Shifrat, 10 mijë vende të lira pune 'online'

Mbi 50 mijë biznese në kërkim, "fshehin" nivelin e pagave

Subjektet private në Shqipëri kërkojnë të punësojnë rreth 10 mijë persona. Vendet e lira të punës janë thauajse në të gjithë vendin. Bëhet fjalë për profesione të ndryshme nga inxhinierë e ekonomistë deri tek rrobaqepës, prestarë, fadromistë etj. Mbi 50 mijë biznese janë në kërkim të punonjësve të ndryshëm përmes faqes zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, "puna.gov.al".

VENDET E LIRA

Konkretisht janë 51.325 punëdhënës të regjistruar, numër ky që është rritur ndjeshëm krahasuar me 3-mujorin e parë të vitit, ku 3 mijë subjekte më shumë janë në kërkim. Ndërkaq, janë rreth 10 mijë vend të lira pune aktive, për të cilat mund të aplikohet, por ajo që vihet re është se në njëjtimet e bizneseve, janë të renditura kërkesat sipas llojit të punës dhe kualifikimit që duhet të kenë punonjësit, ndërsa vetëm pjesa e pagës, e cila duhet shënuar në modelin standard të aplikimit është bosh, çka tregon që punëdhënësit "fshehin" nivelin e pagesave për të interesuarit. Kjo mund të



ndodhë për shkak të konkurrencës në treg, që të mos krijojnë stepje në aplikime, por ka edhe biznese që ofrojnë paga shumë të ulëta, apo nën pagën mini-

male prej 24 mijë lekësh. Ajo që vihet re është se bizneset kërkojnë më së shumti punëtorë krahu me një pozicion që në fakt nuk kërkon as kurse profesionale. Paradoksi është

që ndërkohë që ka shumë vende të lira në këtë pozicion, shumë punëtorë krahu e kalojnë ditën në zona të ndryshme të kryeqytetit, por jo vetëm,

KERKESAT

Arsim të lartë

1. Inxhinierë
2. Ekonomistë
3. Specialistë të rrjeteve kompjuterike
4. Bankierë
5. Programues

Zanatçinjtë

1. Rrobaqepës
2. Prestarë
3. Fadromistë
4. Xhenerikë
5. Vinçierë
6. Saldatorë
7. Këpuçarë
8. Shoferë

në pritje për t'u punësuar apo për të bërë punë sipas nevojave që mund të kenë qytetarë të ndryshëm.

PROFESIONET

Nga lista e vendeve va-

kante të publikuara 'online' vihet re gjithashtu se ka kërkesë të lartë për zanate, si rrobaqepës, prestarë, fadromistë, xhenerikë, vinçierë, saldatorë, këpuçarë, shoferë, hidroalikë, marangoz etj. Gjithashtu, në listën e vendeve të lira të punës e gjejmë veten edhe punëkërkuar me profesione që kërkojnë arsim të lartë, si inxhinierë, ekonomistë, specialistë të rrjeteve kompjuterike, bankierë, programues e deri tek drejtorë. Vendet e punës janë të shpërndara në të gjithë Shqipërinë dhe të interesuarit e kanë shumë të thjeshtë të aplikojnë, përkrah listimit të kërkesës dhe pasi të shohin kualifikimet e kërkuara.

Paraja në qarkullim vijon të tkurret, ra me 1.2% në tremujorin e dytë



Ekonomia këtë vit është rritur me ritmet më të larta, punësimi gjithashtu, por në kundërt të këtyre zhvillimeve, qarkullimi i parasë në ekonomi vijon të bjerë. Banka e Shqipërisë raportoi se treguesi i parasë në monedhë vendëse, agregati M2, vijon të shfaqë tkurrje në terma vjetorë. Ai ka thelluar normën vjetore të tkurrjes në 1.2% mesatarisht në tremujorin e dytë të vitit. Banka e Shqipërisë analizon se ecuria e ofertës monetare vijon të kushtëzohet nga financimi i pakët i qeverisë me mjete monetare të brendshme. Kontributi i kredisë për sektorin privat në rritjen e masës monetare mbetet gjithashtu në nivele të moderuara, duke reflektuar aktivitetin kreditues ende të plogësht. Kushtëzimet në rritjen e masës monetare, në kahun e pasivitetit të sistemit bankar, vijnë në reflektimin

ndryshimit strukturor të zhvendosjes së depozitave në maturitete mbi dy vjet. Ekspertët e Bankës sqarojnë se ecuria e këtij treguesi reflekton nga njëra anë krijimin e ulët të parasë në lekë dhe nga ana

tjetër ndryshimin e pjesshëm të formës së mbajtjes së kursimeve të individëve: nga depozita nën dy vjet, në depozita me afat maturimi mbi dy vjet dhe në një masë më të madhe, në investime në letra

me vlerë të qeverisë. Duke e rregulluar për këtë efekt, norma vjetore e agregatit M2 shfaq rritje me 1.5% vit mbi vit. Gjithashtu, agregati i parasë likuide, M1, ka shënuar ngadalësim të ritmeve të rritjes, në 4.1% në terma vjetorë mesatarë. Paraja jashtë bankave në fund të muajit qershor përbën rreth 35.8% të agregatit M2, ose rreth 27.3% të agregatit M2 të rregulluar. Paraja e gjerë në ekonomi ka vijuar të zgjerohet me ritme të moderuara në tremujorin e dytë të vitit. Korrektuar për kursin e këmbimit, norma vjetore e rritjes së agregatit M3 është luhatur rreth vlerës 2%, në ngadalësim të mëtejshëm krahasuar me një tremujor më parë. Në kahun e aktivitetit të sistemit bankar, krijimi i parasë në ekonomi është mbështetur nga zgjerimi i mjeteve valutore neto të sistemit bankar, të cilat bartin efektin kryesor të mbicimit të monedhës vendëse.



Tatimet, 20 gushti është afati i fundit për pagesën e tatimit në burim

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njoftoi sot të gjithë tatimpaguesit (shoqëritë tregtare/personat juridikë), të cilët sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" kanë marrë vendimin e destinimit të fitimit pas tatimit dhe e kanë shpërndarë atë në formë dividendi, se afati i fundit i deklarimit dhe pagesës së tatimit të mbajtur në burim është data 20 gusht 2018. Deklarimi i shumës së dividendit bëhet përmes deklaratës së tatimit të mbajtur në burim, e cila dorëzohet 'online' në administratën tatimore brenda kësaj date. Paguesa për tatimin bëhet në bankat e nivelit të dytë, brenda datës 20 gusht, pavarësisht nëse është kryer apo jo pagesa e dividendëve për subjektet/individët përfitues. Gjithashtu, ju kujtojmë se në rast mosdeklarimi apo mospagesa në afat të tatimit mbi dividendët, do të zbatohen dispozitat përkatëse ligjore. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mbetet e angazhuar për informimin e tatimpaguesve mbi zbatimin me korrektesë të legjislacionit, si dhe për deklarimet sipas afateve. Sipas legjislacionit në fuqi duhet të deklarohet dhe mbahet tatimi në burim në masën 15 për qind nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë, janë: dividendët, ndarjet e fitimit, interesat, pagesat për të drejtat e autorit dhe për pronësinë intelektuale, pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet financiare dhe ato të sigurimit, pagesat për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues, pagesat për ndërtimin, instalimin, montimin ose për punë mbikëqyrëse që lidhen me to, pagesat për qiratë dhe pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve.

ISH-TE PERNDJEKURIT DOKUMENTET

Përfituesit e kështit të parë dhe të dytë, dokumentet në Drejtorinë e Pagesave

Ornela Manjani

Ish-të përndjekurit, 650 trashëgimtarët marrin paratë

Ministria e Financave: Dorëzoni numrin e llogarisë dhe certifikatat

Rreth 650 fëmijë ish-të dënuarish politikë, trashëgimtarë të radhës së parë do të marrin dëmshpërblimin. Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë jo parësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të dorëzojnë dokumentet deri brenda 3 muajve. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të kështit të dytë të dorëzojnë në drejtorinë e pagesave numrin e llogarisë për të marrë dëmshpërblimin. Lista me përfituesit, të cilët janë në radhë për kështin e tyre të parë dhe të dytë, duhet të përditësojnë numrin e llogarisë bankare, si dhe të dorëzojnë fotokopje të mjetit të identifikimit dhe

ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha do-

kumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes

civile. Ligi parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse

dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve që nuk kanë marrë ende dëmshpërblimin.

documente të periudhës përkatëse

650 TRASHËGIMTARËT MARRIN PARATË

NR. DOSJES	EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPJE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRINGUT FAMILJAR	DISHIMI TRASHGIMIE
20478	MEREME	LIKA					V	V	V
	RAMAZAN	LIKA					V	V	V
			ZEQINE	KAZHAJA	X	X			
			HAZIS	LIKA	V	V			
			XHEMAL	LIKA	X	X			
			ZENEL	LIKA	X	X			
			KUSHE	KAZHAJA	X	X			
			SHEFQET	LIKA	X	X			
	HYSEN	LIKA					V	V	V
			RESTEM	LIKA			V	V	V
			MYFTAR	LIKA			V	V	V
			HAVA	ABDDA			V	V	V
4359							V	V	V
	EVANTH	KATI(NIKOLLA)					V	V	V
	VASIL	NIKOLLA					V	X	X
	ALEKS	NIKOLLA					V	X	X
	KRISTINA	SELUSHTA			V	X			
	KOSTANDIN	NIKOLLA			V	V			
21337							V	V	V
	LULASH	HILU					V	X	X
	NIKE	HILU					V	V	V
			DEDE	HILI			V	V	X
			GJELOSH	HILI	V	V	V	V	X
			KOLE	HILI	V	V	V	V	X
			PETRIT	HILI			V	V	X
			LIN	HILI	V	V			
20743							V	V	V
	SAIT	FUSHA					V	V	V
	FIFE	FUSHA					V	X	X
	MUHAMET	FUSHA					V	X	X
	GIJLJE	FUSHA			V	V			
	ISUF	FUSHA					V	V	V
			XHENAHIR	FUSHA	V	V	V	V	V
			MEHMET	FUSHA	V	V	V	V	V
930							V	V	V
	ABAS	SHEHU					V	V	V
			RUFARJETE	METHOXH A	V	X			
			DALLENDYSH E	KULAJ	V	X			
			MNYR	SHEHU	V	X			
			NEXHMIJE	MUSARAJ	V	X			
			PETRIT	SHEHU	V	X			
			YMET	SHEHU	V	X			
			FQIBETE	LLANAJ	V	X			
			NADIR	SHEHU	V	X			
			ACIM	SHEHU	V	X			
			NIKO	SHEHU	V	X			
			XHULJETA	SHEHU	V	X			
			USHTIMA	SHEHU	V	X			
	HAMDI	SHEHU			V	V			
	BEKHET	SHEHU			V	V			
	ENGIJLUSHE	DERVISHI			V	V			
	GINOVEFA	BREGU			V	V	V	V	V
			ERJON	BREGU	V	V	V	V	V
			LAURETA	BREGU	V	V	V	V	V
			MIRELA	ALLAJ	V	V	V	V	V
	LEONIDHA	SHEKA			V	V			

NR. DOSJES	EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPJE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRINGUT FAMILJAR	DISHIMI TRASHGIMIE
2420							V	V	V
	DRANDE	GURI					V	V	V
	ZDJE	PROGNI			V	V	V	V	V
	LEZE	RAJA			V	V			
	MARI	PERPANAJ					V	X	X
	NDREKE	GURI			V	V			
	LULE	STAVRO			V	V			
	LIN	GURI			V	V			
	MHILL	GURI			V	V			
21064							V	V	V
	LUCE	MUSAI					X	X	V
			LILJANA	MUSSAFI	X	X			
			CRISTOFANO	MUSSAFI	X	X			
			EUGENIO	MUSSAFI	X	X			
	LORENC	GJELOSHI(DEDJA)					V	V	V
	KEL	VATA							
			LEONORA	VATA	X	X			
			EMANUELA	VATA	X	X			
			ALFONS	VATA	X	X			
	LIZE(LEZE)	PLAKAJ					V		
			NIKOLIN	PLAKAJ	X	X			
			MIRUSH	PLAKAJ	X	X			
			MONDI	PLAKAJ	X	X			
			BRUNILDA	PLAKAJ	X	X			
			BLEDAR	PLAKAJ	X	X			
	GIJON	GJELOSHI(VATA)					V	V	V
			NIAC	VATA	V	V			
			LIJIG	VATA	V	V			
			MARJE	DABERDAKU	V	V			
11983							V	V	V
	JEORGJICA	LAZO					V	V	V
	KRISTO	LAZO			X	X			
	ALEKSANDER	LAZO			X	X			
	VANGJEL	LAZO			V	V			
	KLEONIDHI	FOTO			V	V			
	IFIGJENIA	LILI			V	V			
15737							V	V	V
	KOSTANDO	NIKA			X	X			
	KOCO	NIKA			V	V			
	JANI	NIKA			V	V			
	AMALIA	COLLAKU			V	V			
	LEFTERIA	APOSTOLI			V	V			
13489							V	V	V
	ZARJIE	TONUZI					X	V	X
	BUKURIE	LITA(TONUZI)			X	X			
	ZAHIDE	CAMI(TONUZI)			V	V			
	NAZI	TONUZI			V	V			
	SELMAN	HYSENAGOLLI			V	V			
14906							V	V	V
	RUKJIE	KACANI					X	V	V
	AHMEDIE	DACI			V	V			
13489							V	V	V
	ZARJIE	TONUZI					X	V	X

	BUKURIE	LITA(TONUZI)				X	X												
	ZAHIDE	CAMI(TONUZI)				V													
	NIJAZI	TONUZI				V													
	SELMAN	HYENAGOLLI				V	V												
10902										V	V	V							
	SALO	MIRACI								V	V	V							
	OSMAN	MIRACI								V	V	V							
	FATIME	CEPE								V	V	X							
	HANUSHE	LALA								V	X	V							
		AFRIM	LALA			V	V												
		HELVETINE	AHMETAJ			V	V												
		BARDHOSHE	SHANI			V													
		DONIKA	HUSI			V	V												
		ILJAS	LALA			V													
		ERMIRA	NIKA			V	V												
	MAZUJE	NANI				V	V												
15220										V	V	V							
	MAMUDE	HAXHIRAJ								V	V	V							
	HAXHI	HAXHIRAJ								V	V	V							
		SHPETIM	HAXHIRAJ			V													
	SADUSHE	MERAJ				V													
	SHABAN	HAXHIRAJ				V				V	X	V							
		MUHARREM	HAXHIRAJ			V	X												
		NOVRUZ	HAXHIRAJ			X	X												
		NAXHBE	ALIAJ			X	X												
		YSNIE	VEZAJ			X	X												
		A DRIATIK	HAXHIRAJ			X	X												
	FADIL	HAXHIRAJ								V	V	V							
		PORTOKALLE	RAMAJ			V													
		NIMETE	HAZIJAJ			V													
		VATHI	XHELAJ			X	X												
		PUSHIME	CALA			V													
		NORI	HAXHIRAJ			V	V												
		ADELJNA	HAXHIRAJ			V													
		MYZAFER	HAXHIRAJ			X	X												
		DESHIRA	HOXHAJ			V													
	HASAN	HAXHIRAJ								X	X	V							
		NURIDIN	HAXHIRAJ			V													
		RUKIE	MUSARAJ			V													
		FIDAI	HAXHIRAJ			X	X												
		IBRAHIM	HAXHIRAJ			X	V												
	XHEMAL	HAXHIRAJ								V	X	X							
	HYSNIE	MAHLANJ								V	X	X							
	NEVRIE	KAPAJ				V													
	YLMI	HAXHIRAJ				V													
	FATIME	CELAJ				V													
		IBRAHIM	HAXHIRAJ			V	V												
19033										V	V	V							
	HARILLOAS	GJIKURIA				V	V			V	V	V							
	LJUKA	GJIKURIA				V	V												
	KATINA	DJINI				V	V												
	YASLIQI	MUCO				V	V												
	ZAHARLILLA	DJINI				V	V												
	VASIL	GJIKURIA								V	X	V							
		ANGJELIQI	GJIKURIA			V	V												
		HEKTOR	GJIKURIA			V	V												
		MEROPI	GJIKURIA			V	V												
21486										V	V	V							
	PRENE	LLESHI								V	V	V							
		FRBOK	DODA			V													
		GJON	DODA			V													
	DILA	LLESHI				V													
		SENTILJAN	NDREU			V	V												
		MARKEL	DODA			V	V												
										V	V	V							
20661										V	V	V							
	ZEGJINE	DIGNOZI								V	V	V							
		TAFIL	DKNGOZI			V	V												
		VEZHANE	TUFA			V	V												
	XHAFERR	HOXHA								V	V	V							
		FATIME	DEDEJ			V	V												
		DILFIQARE	UKU			V	V												
		ILMI	HOXHA			V	V												
	RUSTEM	HOXHA								V	V	V							
		RUZHDE	DINI			V													
		BESHIT	HOXHA			V													
		JONUS	HOXHA			V	V												
		MYFIT	HOXHA			V													
		KASEM	HOXHA			V													
		LUFTAR	HOXHA			V													
		SHUAJ	HOXHA			V													
		ZENUN	HOXHA			V	X												
		ARDJAN	HOXHA			V													
	SELIME	MUCA				V	V												
	BESIM	HOXHA				V	V												
	IDRIZ	HOXHA				V	V			V	V	V							
		PELLUMB	HOXHA			V	V												
		YLLI	HOXHA			V													
18218										V	V	V							
	DODE	ALIAJ								X	X	V							
		VERA	ALIAJ			V													
		PIETER	ALIAJ			V													
		MARINA	ALIAJ			V													
						X	X												
	DRANE	ALIAJ				V	V												
	GUVSTE	ALIAJ				V	V												
	DIELLA	SMALIJAJ				V	V												
	LENA	LLOGORI								V	X	V							
		EJELL	LLOGORI			V	V												
20236										V	V	V							
	MIROSHE	ALIAJ				V	V												
	NURE	LAMAJ				V	V			V	V	V							
		VIRION	LAMAJ			V	V												
		TELTA	YMERI			V	X												
		LUZA	XHERAHU			V	V												
		SHEFIKATE	MALAJ			V													
	SPIRO	MUCAJ				V	V												
	REFUJE	SHORAJ				V	V			V	V	V							
		MERKO	SHORAJ			V	V												
		HYDAI	SHORAJ			V	V												
		GJERGJI	SHORAJ			V	V												

						FLORETA	LUZAJ	X	V										
						SUZANA	HADERI	V	V										
						SHPETIME	LUARI	V	V										
						HIQMET	SHORAJ	V	V										
18834															V	V	V		
	MARUJE(MRU)	GJELAJ												V	V	V			
						TONE	GJELAJ	V											
						PASHKO	GJELAJ	V	V										
						LULE	MITAJ	V											
						GJELOSH	GJENAJ	V											
						PASHKO	GJONAJ	V	X					V	V	V			
19636														V	V	X			
	ZELIHE	SEFAJ												V	V	X			
	HAMIT	SEFAJ												V	V	V			
						ARMAND	SEFA	V	V					V	V	V			
	ALI	SEFAJ												V	V	V			
						MIDE													

Drejtori i 'CRCA Albania': Të miturit braktisin shkollën, drejtorët deklarojnë ndryshe

Altin Hazizaj: Alarmi, rreth 50 mijë fëmijë në Shqipëri detyrohen të punojnë

"Mbi 50% pohojnë se janë dhunuar nga familja"

Voltiza Duro

Rreth 50 mijë fëmijë në vendin tonë janë të detyruar të punojnë, ndërkohë që 2600 prej tyre jetojnë në situatë rruge. Shifrat alarmante të publikuara nga INSTAT pak kohë më parë ka sjellë reagimin e organizatave që llobojnë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Altin Hazizaj, drejtor i përgjithshëm i CRCA Albania (Children's Human Rights Centre of Albania) tregon se financimet e qeverisë për mbrojtjen e fëmijëve mbeten në nivele tepër të papërfillshme. Më tej, Hazizaj thekson se sipas studimit të BECAN, rezultoni se mbi 50% e fëmijëve raportojnë dhunë fizike në familje, në një kohë që rreth 11% e tyre pohojnë se janë viktimat e dhunës dhe ngacmimeve seksuale në familje dhe shoqëri.

Sa të mbrojtur janë fëmijët në vendin tonë? A ka një sistem funksional që i siguron ata?

Pavarësisht se Shqipëria ka bërë shumë ndryshime dhe përmirësime në drejtim të mbrojtjes së fëmijëve, përsëri jemi ende shumë larg të ngritjes së një sistemi funksional të mbrojtjes së fëmijës. Nëse do të duhej të jepja një përgjigje të shkurtër, ajo do të ishte: fëmijët në Shqipëri janë të pambrojtur dhe shpesh janë viktimat të mosfunksionimit të shtetit dhe të të gjithë hallkave të tij. Rasti më i fundit i dhunës fizike dhe seksuale ndaj disa fëmijëve na kanë treguar sesa të paafat janë bashkitë që të mbrojnë fëmijët. Në nivel kombëtar, ne jemi thellësisht të shqetësuar që financimet e qeverisë për mbrojtjen e fëmijëve mbeten në nivele tepër të papërfillshme dhe për më tepër ato nga viti në vit kanë ardhur duke u ulur, duke treguar që fëmijët nuk janë një grup prioritar për qeverinë.

Sipas statistikave, sa është numri i fëmijëve që detyrohen të punojnë?

Të dhënat zyrtare nga INSTAT raportojnë nivele shqetësuese të punës dhe shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve në Shqipëri. Rreth 7% e fëmijëve nën moshën 18 vjeç shfrytëzohen nga familjet dhe biznesi për punë të paligjshme, ose përafërsisht rreth 50,000 mijë fëmijë. Kjo shifër përfaqëson thuhet 50% të fëmijëve që Banka Botërore i raporton si fëmijë që jetojnë në nivelin e varfërisë, që është tregues i lidhjes që ka varfëria me punën dhe shfrytëzimin e fëmijëve. Ndërkohë që brenda këtij grupi, kemi edhe fëmijët që



Altin Hazizaj, drejtor i përgjithshëm i 'CRCA Albania'



jetojnë në situatë rruge duke lypur, të cilët numërohen në rreth 2600 fëmijë.

Sa është numri i të miturve që kanë braktisur shkollën për shkak të pamundësisë ekonomike të familjeve të tyre?

Braktisja e shkollës sipas shifrave zyrtare është e ultë në Shqipëri, ndërmjet 1-3 përqind. Ajo ç'ka përbën shqetësimin për ne është braktisja e fëmijëve dhe shkollës. Në shumë raste Rrjeti për Arsimin në Shqipëri ka ngritur shqetësimin e anëtarëve të tij që shumë fëmijë largohen nga bankat e shkollës, por ata deklarohen nga drejtorët sikur janë aty dhe kjo sepse rritja e braktisjes mund të shpjëjë në pushimin apo largimin e tyre nga puna.

Si paraqiten shifrat e fëmijëve të dhunuar në vendin tonë? Sa mbrojtje ofron shteti në këto raste?

Sipas studimit të BECAN, që është studimi më i madh i kryer ndonjëherë në Shqipëri mbi dhunën ndaj fëmijëve, rezultoni se mbi 50% e fëmijëve raportojnë dhunë fizike në familje. Rreth 11% e tyre raportuan se janë viktimat të dhunës dhe ngacmimeve seksuale në familje dhe shoqëri. E megjithatë dhuna mbetet një ndër fenomenet që seriozisht shkatërron mirëqenien e fëmijës dhe ku shteti shqiptar (qeveria dhe bashkitë) nuk ofrojnë asnjë shërbim për mbrojtjen, kujdesin dhe rehabilitimin e tyre. Është e paimagjinueshme, por Shqipëria është i vetmi

Ajo ç'ka përbën shqetësimin për ne është braktisja e fëmijëve dhe shkollës.

Në shumë raste Rrjeti për Arsimin në Shqipëri ka ngritur shqetësimin e anëtarëve të tij që shumë fëmijë largohen nga bankat e shkollës, por ata deklarohen nga drejtorët sikur janë aty dhe kjo sepse rritja e braktisjes mund të shpjëjë në pushimin apo largimin e tyre nga puna.

shtet në Europë që nuk ka asnjë shërbim të financuar dhe mbështetur nga shteti për fëmijët që i mbijetojnë dhunës. Pavarësisht se ne si CRCA ka vite që i kërkojmë edhe Kuvendit edhe qeverisë që ta marrë seriozisht këtë çështje, fatkeqësisht jemi ende shumë larg mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna, kudo ajo ndodh. Nëse ka një gjë që mbase kjo qeveri do të mbahej mend është fakti sesa pak ka bërë ajo për të mbrojtur fëmijët!

A ka fëmijë të trafikuar në Shqipëri? Nëse po si shfrytëzohen këta të mitur?

Para pak ditësh së bashku me ECPAT Shqipëri, ne kemi bërë një reagim publik për të kërkuar një përgjigje me të fuqishme nga ana e qeverisë dhe institucioneve në lidhje me këtë fenomen shkatërrues të fëmijëve. Po ka trafikim të fëmijëve! Shqipëria mbetet një ndër vendet kryesore të origjinës të trafikimit të fëmijëve në Europë, sidomos në Britaninë e Madhe. Edhe raporti më i fundit i Departamentit të Shtetit ndante të njëjtin shqetësim me ne, atë të mungesës së arrestimeve dhe dënimeve të kujtdo që trafikon dhe shfrytëzon fëmijët. Në Shqipëri ka dy forma kryesore të trafikimit të brendshëm: për lypësit dhe për prostitucion. Raportimet nga komunitetet ku ne punojmë na tregojnë se prostitucioni i fëmijëve të varfër dhe të pambrojtur, që vijnë nga familje abuzive apo të shkatërruara, është gjithnjë e në rritje.

A duhen bërë ndryshime në ligjin për mbrojtjen e fëmijëve?

Jo, pasi ligji i ri u miratua tani vonë dhe ende nuk i është dhënë mundësia të zbatohet si e sa duhet. Jo vetëm qeveria, por sidomos bashkitë kudo në vend, janë ende tepër larg të të kuptuarit dhe të zbatuarit të ligjit të ri të fëmijëve! Mendoj, në fakt, që ka

11%

NGACIM SEKSUAL

Sipas studimit të BECAN, rezultoni se mbi 50% e fëmijëve raportojnë dhunë fizike në familje, në një kohë që rreth 11% e tyre pohojnë se janë viktimat e dhunës dhe ngacmimeve seksuale në familje dhe shoqëri.

Cila është thirrja juaj ndaj instancave përkatëse lidhur me të drejtat e fëmijëve në vendin tonë?

Shqipëria në vitin 2019 do të raportojë për herë të tretë për situatën e të drejtave të fëmijëve në OKB. Për të kësaj Shqipëria do të raportojë edhe për UPR (universal periodic review) ku fëmijët zënë një rol tepër të rëndësishëm. Dy raportet e para çojnë disa shqetësime tepër serioze në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve. Unë nuk besoj se hera e tretë ka për të qenë e lehtë dhe mendoj se qëndrimi

REAGIMI

Para pak ditësh së bashku me ECPAT Shqipëri, ne kemi bërë një reagim publik për të kërkuar një përgjigje me të fuqishme nga ana e qeverisë dhe institucioneve në lidhje me këtë fenomen shkatërrues të fëmijëve. Po, ka trafikim të fëmijëve! Shqipëria mbetet një ndër vendet kryesore të origjinës të trafikimit të fëmijëve në Europë, sidomos në Britaninë e Madhe.

i OKB-së ka për të qenë tepër kritik në këtë aspekt. Nëse kam një thirrje sot për çdo politikan dhe institucion, ajo do të ishte: Mos humbini kohë për të mbrojtur fëmijët! Një fëmijë pa të sotme nuk ka të ardhme!

Çfarë është CRCA dhe cili është misioni i saj?


CRCA Shqipëri është organizata kryesore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri. Ne ka tashmë 21 vjet që i jemi dedikuar avokatësisë dhe denoncimit të çdo shkeljeje dhe mosveprimi të shtetit shqiptar për të respektuar, mbrojtur dhe garantuar të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri. Motivi i CRCA-se bazohet në thënieën: "Duke punuar të gjithë së bashku, ne mund të ndërtojmë një Botë më të mirë për fëmijët dhe të rinjtë." Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA) punon për të promovuar respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve, për t'i mbrojtur ata nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi, për të zhvilluar të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri, për të rritur pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në nivelin kombëtar dhe lokal, nëpërmjet lobimit dhe avokatësisë, përmirësimit të politikave dhe legjislacionit, ngritjes së kapaciteteve, informimit dhe hullumtit, si dhe krijimit të modeleve të mira të shërbimeve për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve.

HAPJA E DOSJES

HAVZI NELA: Do të bindem vetëm kur të bëhem dhe...

S hënim Operativ: "Unë punëtori... mora pjesë në internimin e Havzi Nelës. Havziu u shpreh se: 'Kaq i rrezikshëm paskam qenë unë për partinë sa ma çoi gjithë jetën burgjeve?'- unë i thashë se 'Ti ke bërë krim dhe për këtë të falënderosh partinë që të fali jetën' - ndërsa Havziu ma ktheu: 'Unë nuk ia di për nder askujt, sepse e kam shlyer me jetën time'". Pastaj S.G. i tha Havziut se po bën gabim që po flet kështu dhe për këtë do të bindesh vetë. "Unë - tha Havziu - do të bindem vetëm kur të bëhem dhe, por më vjen keq që ju po merrni në qafë shumë njerëz të ndershëm duke dëgjuar lloj-lloj maskarai e batakizu, sepse ku e dinit se unë nuk mund të bëhem një njeri i denjë, por mund të bëhesha agjent, që po më internoni...". Kjo është vetëm një fletë nga dosja e hetimit dhe dënimit të Havzi Nelës, poetit kukësi që doli kundër regjimit komunist. Në 30-vjetorin e vdekjes së mësuesit dhe poetit nga Kukësi, Autoriteti i Dosjeve për herë të parë vë në dispozicion të studiuesve dokumentet e deklasifikuara që i përkasin dosjeve formulare të krijuar nga ish-Sigurimi i Shtetit. Në faqe të tjera, Nela citohet të ketë thënë se, "situata në vendin tonë është shumë e turbullt dhe se këtyre u ka shpërthyer vullkani në udhëheqje, prandaj i kanë ditët të numëruara. Qeveria e këtij udhëheqsi e mban popullin në diktaturë terroriste". "I pandehuri, Havzi Nela, i biri i Shabanit dhe i Xhevahires, i lindur më 1934 në Kallolovoz të Kukësit, me origjinë shoqërore fshatar i varfër, me gjendje shoqërore punëtor, me profesion arsimtar, me arsim të lartë të pambaruar, me gjendje familjare i martuar pa fëmijë, i dënuar me 15 vjet heqje lirie, në bazë të nenit 64/ 14 të Kodit Penal, me vendim nr. 25 data 22.5.1967, të Gjykatës së rrethit Shkodër, i arrestuar më 30.5.1975, i akuzuar se ka bërë agjitacion e propagandë kundër Pushtetit Popullor, ka kryer krimin e parashikuar prej nenit 73/1 të Kodit Penal, gjykata pasi shqyrtoi materialin e hetuesisë, provat e marra gjatë zhvillimit të gjykimit, mbrojtjen dhe fjalën e fundit të pandehurit, i cili kërkon drejtësi, vendosi: Ta deklarojë fajtor të pandehurin Havzi Nela, për krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër pushtetit popullor dhe në bazë të nenit 73/1 të Kodit Penal e dënon me 8 vjet heqje lirie. Përfundimisht në aplikim të nenit 49, të Kodit Penal e dënon me 12 vjet heqje lirie", shkruhet në vendimin e datës 8 gusht të vitit 1975 të Gjykatës së rrethit Mirditë, e cila e dënon Nelën me 12 vjet heqje lirie. Në kampin e Spaçit, i pandehuri gjatë vitit 1974 dhe 1975, me të dënuar të ndryshëm ka bërë biseda armiqësore kundër pushtetit popullor. E përfundoi arsimin e lartë në Shkodër, me korrespondencë e më pas punoi si mësues në Krumë, Lojmë dhe Shish-

Autoriteti hap dosjen e poetit kukësi 30 vite pas vdekjes, e vë në dispozicion të studiuesve



tavec i deri në vitin 1967, kur u transferua në Topojan, vendi ku nisi edhe kalvari i tragjedisë së tij. Dënimi me 15 vite heqje lirie, në vitin 1967 i erdhi për shkak se kishte kaluar kufirin drejt Kosovës, por forcat jugosllave e dorëzuan sërish në Shqipëri. Edhe bashkëshortja e tij u dënua me 10 vite burg. Gjatë gjithë kohës i vëzhguar nga Sigurimi, në vitin 1986, e lejuan që për një kohë të shkurtër të dilte nga burgu, liri që nuk do të zgjaste shumë, pasi në vitin 1987 arrestohet sërish. Më 1988 e varën në qytet. Me rastin e 30-vjetorit të varjes së poetit dhe mësuesit, Bashkia e Kukësit pasi vendosi bustin e poetit në gjimnazin e qytetit, ka përuaruar shtëpinë e Havzi Nelës në fshatin Kollovoz, ku thuhet se poeti kishte gëpusur dorëshkrimet e tij të fundit, që të mos binin në duart e Sigurimit të Shtetit.

Brizida Gjykondi publikon imazhet: Degradimi i muzeut të Butrintit

"Muzeu brenda i ngjante një saune me erë myku nëpër mure dhe llamba të djegura, ku mezi dalloje ç'shkruej"

A vokatja dhe aktivistja e shoqërisë civile, Brizida Gjykondi ka publikuar imazhe të turpshme nga Butrinti. Muzeu i tij, lart në kodër i është dorëzuar mykut e lagështirës. Në tetorin e vitit të kaluar, një debat i madh e përfshiu parkun, teksa një vendim i Ministrisë së Kulturës i hapi rrugë ndërtimit mbi një godinë ekzistuese të një bar-kafeje si "pikë shërbimi" përmes formulës së bashkëpunimit me privatizim. Pothuaj një vit më vonë, vizitorët kanë denoncuar çmimet e larta në këtë pikë shërbimi, që në krye të herës u tha se do u shërbente turistëve në pikun e udhëtimit të tyre dyorësh. Por duke lënë mënjanë shqetësimin se ku do freskohen turistët, ajo që del në pah tanimë nga një "turiste" është gjendja e mjerueshme e muzeut. Me gjithë ecejaket e Ministrisë së Kulturës nga Tirana drejt Butrintit në gjithë këto kohë e me gjithë debatin për Butrintin, planin e munguar të menaxhimit, parkun e mbrojtur nga UNESCO e më gjerë, askujt nuk i ka rënë në sy, ose së paku nuk ka ndërhyrë për të neutralizuar lagështirën në muzeun që sipas vetë ministrisë shënon pikun e vizitës dyorëshe. Pra, çfarë ndodh? Ministria kujdeset për kafe e ujë për vizitorët, por në këtë turrravrap për shërbim neglizhon atë që duhet të ofrojë Butrinti: një muze për të qenë. Lagështirja nuk është vetëm çështje vizuale, më së pari një muze duhet të ketë kushtet e duhura për të



strehuar artefaktet që mban, të trashëguara nga shekujt e zbulimet e kohëpaskohshme në zonë. "Butrinti dhe muzeu i tij në një degradim total. Në hyrje nuk punonin kontrolluesit e biletave. Sporte-lit dhe sportelistic, të lodhur. Askund ciceron. Policët privatë të veshur me rroba zgyjër. Muzeu brenda i ngjante një saune me erë myku nëpër mure dhe llamba të djegura ku mezi dalloje ç'shkruej. Oborri dhe rrethinat me bimësi mjerane, shoqëruar me ndonjë tabelë qesharake. Për shembull,

kjo është rozmarinë ose kjo pema është eukaliptus. Ndërkohë, s'kish tabela dhe sinjalistikë aty ku ndahesh amfiteatri me shkallët e muzeut dhe njerëzit ecnin kulturor. U largova e trishtuar. Butrinti, një pasuri botërore nëpër libra historie, por jo shqiptare në Shqipëri. Shteti im, asnjëherë nuk po më zhgënjën", shkruan Gjykondi. Postimi në logarinë e aktivistes në "Facebook" zhbën dhjetëra e dhjetëra postime të Ministrisë së Kulturës për mirëmbajtje monumentesh. "Ne në ruajtje të trashëgimisë kul-



tureore kemi bërë një studim për të parë se cilat janë hapësirat ekzistuese brenda siteve, të cilat mund të ripërdoren, të rifunksionalizohen për të krijuar standarde shërbimi. Ne kemi sot 170 mijë vizitorë në vit në Butrint. Kjo kërkon një menaxhim. Kemi ndërhyrë në Butrint me mbi 15 projekte, mirëmbajtje e restaurimi, si skena e amfiteatrit etj.", shprehej ministria e Kulturës, Mirela Kumburo në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" më 11 tetor 2017. Imazhet që shihni janë ato të muzeut me të cilin këta 170 mijë vizitorë përballen. Po, trashëgimia është motor zhvillimi.

Nata e katërt e Festës së Birrës ‘ngre në këmbë’ qytetin, surprizat s'kanë fund

Manolito i "Gipsy King" ndez festën në Korçë, ambasadorja slovene: "Birra Korça", shije unike

Lea Stançiç: Kam vizituar qytetin dhe fabrikën. Ua rekomandoj të gjithëve

Të 13 standat e "Birra Korçës" ishin të mbushura me qytetarë nga e gjithë Europa, që erdhën në qytetin juglindor për Festën e madhe të Birrës, traditë kjo tashmë e konsoliduar. Festa që nis në 9 të mbrëmjes e që mbaron në orët e para të mëngjesit, dhe ka pasur një kulm në natën e katërt të festimeve. Manolito i "Gipsy King Family" ka qenë i ftuar special, ndërsa hiti i grupit famoz, "Bamboleo", "tërboi" të gjithë të pranishmit. Krahas tij performoi Deviz Xherahu dhe vajza surprizë e këtij edicioni, DJ izraelite. Nga ana tjetër, në pazarin e Korçës ishin të ftuar Ad Disha, DJ famoz në Shqipëri dhe "All in band". Ambasadorja slovene ka qenë pjesë e festës së "Birra Korça". Zonja Lea Stançiç tha për "News 24" përshlyetje saj për festën, qytetin dhe "Birrën Korça". "Kam qenë në qytetin e Korçës disa herë dhe më pëlqen shumë këtu. Kam vizituar Dardhën, Voskopojën si edhe qytetin. Kam parë nga afër muzeun e artit mesjetar, pjesën e vjetër të qytetit, Pazarin e Vjetër dhe për mua është gjithmonë kënaqësi të rikthehem këtu. Po ashtu, kam vizituar dy herë fabrikën e "Birrës Korça" dhe me të vërtetë më pëlqen ta shijoj këtë birrë. Vlerësoj mikesitë si edhe organizimin e këtij eventi. Sonte është shumë bukur. Shumë njerëz të rinj, muzikë e bukur. Do t'ua rekomandoja të gjithëve të bëhen pjesë e kësaj feste". Në mes të qytetarëve ishte




edhe një familje nga Brukseli, vendi që ka shumëllojshmëri birrash. "Kishim dëgjuar e si qejflin që jemi,

thamë të vizitojmë Korçën e Shqipërinë me këtë rast. 'Birra Korça' qenka e hatashme, me një shije të veçantë, që i



përputhet në mënyrë fantastike situatës festive", - thonë ata. Ndërkaq, një çift nga Zelanda e Re vizitonin

pafund stendën e birrës, ndërsa thonë që janë të etur për shijen fantastike të "Birra Korça".



SHKURT

Pezullohet shefi i policisë së burgut

FUSHE KRUIJE - Pezullohet nga detyra shefi i policisë në burgun e Fushë-Krujës. Bëhet fjalë për Tofik Sinanin, i cili u pezullua pasi një i dënuar tentoi vetëvrasjen. Mësohet se shtetasi me inicialet T.D. tentoi të vetëvritej, ndërkohe që familjarët bënë ankesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Ka qenë avokata e Popullit, Erinda Ballanca, ajo që ka kërkuar nisjen e hetimeve për rastin në fjalë, ndërkohe që në ambientet e vuajtjes së dënimit u dërguan edhe inspektorët. Pavarësisht këtij hapli, përfaqësuesi i AP-së nuk u lejua të hyjë në burgun e Fushë-Krujës. Kujtojmë se para 10 ditësh në të njëjtin burg u dhunua dhe i dënuari Adriatik Lala, ndërsa dyshohet se pas kësaj ngjarjeje fshihet policia e burgut.

Aksidenti tragjik në Pukë, përmbysët vinçi

Një aksident tragjik ka ndodhur sot në aksin Pukë-Shkodër, ku për pasojë ka humbur jetën një person. Ngjarja ndodhi në vendin e njohur si "Kthesa e gomsiqes". Një vinç është përmbysur në rrugë, e për pasojë një person ka mbetur i vdekur, ndërsa një tjetër që ka qenë në mjet është plagosur. Burime zyrtare thonë se viktimat ndodhet poshtë mjetit me targe AA 706AV, është shtetasi Fredi Fishta. Ndërkohë, pasagjeri Gent Ndoci ka mundur të dalë nga mjeti, ndërsa ka shpëtuar pa pasojë të mëdha. Në vendin e ngjarjes shkuan forcat e zjarrfikëses dhe policia, të cilat tentua që të lëvizin mjetin dhe të nxjerrin prej aty viktimën. Dyshohet se vinçi i janë dëmtuar frenat, duke shkakuar kështu tragjedinë.



Depozitat Fibank - interesate larta dhe fleksibilitet

Depozitat Fibank kombinojnë kushte të ndryshme në mënyrë që të plotësohen sa më shumë kërkesat dhe dëshirat e klienteve.

Ofrohet mundësia e Depozitave afatgjata si Depozita Dinamike 4 vjeçare, me norma interesi progresive deri në 6.5% në Lek, 2.5% në EUR/USD dhe nuk e humb interesin e viteve parardhese nese e mbyll para afatit. Ofrohet edhe "Depozita 2 Vjeçare" me interes fiks 2% në Lek & 1% në EUR.

Fibank ka një Llogari Kursimi me norme interesi me të lartë se i një depozite 1 vjeçare standarte në sistemin bankar! Në Llogarinë e Kursimit mund të menaxhohen mjaft mire kursimet në LEK, EUR dhe USD. Kjo llogari është pa afat dhe në të mund të depozitohet e terhiqet kurdo që klienti dëshiron, pa i humbur interesat.


Diversifikimi i depozitave ka konsideruar madje edhe dëshirën e disa klienteve që të mund ta shijojnë interesin e depozites se tyre që në ditën e pare. Nese klienti do të donte të perdorte në avance shumën e perfituar nga depozita për pushime apo çfaredo shpenzimi, Fibank ofron Depozitën "Rekord" në LEK, EUR dhe USD. Kjo depozite është një kombinim i interesave të larta dhe pageses se menjehershme të të gjithë shumës se interesit në ditën e depozitimit.

Duke qenë një banke dinamike me vendimmarrje teper të shpejte, Fibank e ka të mundur të ofrojë produkte të diversifikuara dhe fleksibel me një shërbim cilësor të pershtatur me se miri ndaj çdo kerkese specifike të klienteve.

Terneq & shton kurao, pa humbur interesat!

Normë Interesi deri në:


- 6.5% në LEK
- 3.5% në EUR



"Prestige Resort", tashmë shija e hollë e sushit në resortin gjigant

"Prestige Resort", shija e hollë, qetësia e komoditeti është gjithçka që dikush kërkon për pushimet, por e kombinuar edhe me një shumëllojshmëri të gatimeve, i bën ato të paharrueshme. Nga sot, për këdo që kërkon të provojë shijen e vërtetë të sushit, e gjen në restorantin e ri, i cili do të jetë në shërbim të pushuesve, duke nisur nga mbrëmja e djeshme. E konceptuar në stilin e kuzhinës fusion, restoranti i ri do të ofrojë shumëllojshmëri gatimesh për të gjithë pushuesit që do ta frekuentojnë atë, ku baza e gatimeve do të jetë sushi, për t'iu përshtatur kështu shijëve të të gjithëve turistëve jo vetëm vendës, por edhe të huaj, të cilët kanë zgjedhur "Prestige Resort" për të kaluar pushimet e tyre në këto ditë të nxehta vere. Sushi restorant vjen në "Prestige Resort" si një bashkëpunim mes "Fab Beach Club" dhe "Mado Fusion Tirana". Kështu nga sot, "Prestige Resort" do të ofrojë për klientët e saj jo vetëm argëtim e ambiente komode, por krahas kuzhinës së pasur tradicionale, me ushqime të freskëta, një tjetër alternativë për ta do të jetë sushi restorant.





NJË LETËR PA PËRGGJIGJE DHE E ARDHMJAE PIRAMIDËS

NGA BEN ANDONI

Michael Granoff është kryetar i Bordit të të Besuarve, pjesë e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit. Prej kohësh atij i është përcjellë një letër nga një grup vepërimtarësh, por që është firmosur nga dy aktivistë të njohur të komunitetit hebre dhe shqiptar në lidhje me një çështje që ka lidhje me procesin e transformimit të ish-Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës (QNK) në një inkubator për novatorizmin dhe sipërmarrjen për rin-

inë. QNK ose ndryshe siç njihet Piramida mbart një trashëgimi të madhe dhe në dekadën e fundit është degraduar në atë masë, sa që është kthyer në një nga pikat më tërheqëse për turistët për t'u treguar fytyrën live të socializmit shqiptar. Zoti Berisha bashkë me një shpurë të tërë të gjithë fushave

ishin gati ta hidhnin në erë, pasi sipas tyre ajo përcillte trashëgiminë e komunizmit dhe mbi të gjitha destinacioni i saj lidhej me kujtimin e Enver Hoxhës. Debat i madh që pasoi dhe presioni nga të gjitha fushat bëri që Piramida të ruhej, por ndërkohë pjesa e saj kryesore filloi të degradonte frikshëm.

Pas shumë vitesh në aktivizmin e tij tepër energjik kryetari i bashkisë së Tiranës, z. Erjon Veliaj, nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me dy bashkë-drejtorët e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit në Tiranë për ta transformuar ish-Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës në një inkubator për no-

vatorizmin dhe sipërmarrjen për rininë. Pa mohuar rëndësinë e këtij aksioni të lavdërueshëm dhe gjetjen e qëllimit për godinën, duhet të themi se destinacioni do të shkonte shumë më mirë një ndërtesë me një arkitekturë krejt tjetër,

→ Vizion në faqen 18

In Memoriam

NGA BAJRAM SEFAJ

Tek po ndiqja (shikoja dhe dëgjoja), tash një ditë frik, intervistën e të bijës së Eqrem Çabejt, Brikena Çabej, dhënë televizionit KTV të Kosovës, gjersa me krenari, pietet dhe respekt të merituar, fliste për babën e saj, shkencëtarin dhe pedagogun tonë të njohur, me ra ndër mend se, këtu e dyzet vjet më parë, me rastin e vdekjes së këtij njeriu të madhtë shkencës dhe, përgjithësisht të kulturës shqiptare, kam bërë një shkrim dhe se, në alfabetin cirilikë, e kam botuar në gazetën "Jedinstvo" të Prishtinës, e cila atëbotë, shquhej për shovinizëm, mos durim, kundër shqiptarizëm të skajshëm. Se si dhe qysh ndodhi kjo, me pak fjalë, shpjegimi ne vijim...

Një "histori" e pabesueshme rreth një artikulli të bashkëpunëtorit tonë, botuar në të përditshmen gazetë serbe "Jedinstvo" të Prishtinës, më 30 gusht 1980, me rastin e vdekjes së Eqrem Çabej. Të botohet në faqen 10, në rubrikën: kultura, umetnost, nauka (kulturë, art, shkencë), artikull me titull të madh "Velikan albanologije i balkanologije", i një gazetari shqiptar, me rastin e vdekjes së një shkencëtari të shquar shqiptar, sikurse që Eqremi ynë, ishte një gjë e jashtëzakonshme, si pamundshme dhe pabesueshme fare! Ndodhi kjo befasi në vigjiljen e vitit kryq (kthesë) 1981, kur nisi grevat e studentëve shqiptarë të Kosovës, që shënonin fillimin e rrënimin të themeleve të ish Jugosllavisë (së Titos!). "Aty nisi (krisi)..."



Si e përcolli propaganda serbe vdekjen e profesor Çabejt?!

→ Vizion në faqen 15

{ Në këtë numër: BAJRAM SEFAJ, KLASIKËT E POEZISË (SHEKSPIR, SZYMBROSKA, KAVAFIS, BRODSKI, MONTALE, PESSOA, DIMITROVA, BACHMANN), VALBONA ZHUPA }

P PIRAMIDA

NGA BEN ANDONI

→ Vije nga faqja 13

Michael Granoff është kryetar i Bordit të të Besuarve, pjesë e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit. Prej kohësh atij i është përcjellë një letër nga një grup veprimtarësh, por që është firmosur nga dy aktivistë të njohur të komunitetit hebre dhe shqiptar në lidhje me një çështje që ka lidhje me procesin e transformimit të ish-Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës (QNK) në një inkubator për novatorizmin dhe sipërmarrjen për rininë. QNK ose ndryshe siç njihet Piramida mbart një trashëgimi të madhe dhe në dekadën e fundit është degraduar në atë masë, sa që është kthyer në një nga pikat më tërheqëse për turistët për t'u treguar fytyrën live të socializmit shqiptar. Zoti Berisha bashkë me një shpurë të tërë të gjithë fushave ishin gati ta hidhnin në erë, pasi sipas tyre ajo përcillte trashëgiminë e komunizmit dhe mbi të gjitha destinacioni i saj lidhej me kujtimin e Enver Hoxhës. Debat i madh që pasoi dhe presioni nga të gjitha fushat bëri që Piramida të ruhej, por ndërkohë pjesa e saj kryesore filloi të degradonte frikshëm.

Pas shumë vitesh në aktivizmin e tij tepër energjik kryetari i bashkisë së Tiranës, z. Erjon Veliaj, nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me dy bashkë-drejtorët e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit në Tiranë për ta transformuar ish-Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës në një inkubator për novatorizmin dhe sipërmarrjen për rininë. Pa mohuar rëndësinë e këtij aksioni të lavdërueshëm dhe gjetjen e qëllimit për godinën, duhet të themi se destinacioni do t'i shkonte shumë më mirë një ndërtesë me një arkitekturë krejt tjetër, por edhe një hapësirë tjetër në qytetin tonë, i cili është shtrirë shumë në drejtimet lindore dhe verilindore. Një gjë që nuk po merret parasysh nga pushtetarët e vendit tonë, që mundohen ta grumbullojnë çdo gjë në qendër të qytetit.

Prej pak kohësh apelojmë që kjo godinë (Lexo: QNK ose Piramida), duke marrë parasysh gjendjen katastrofike të Bibliotekës Kombëtare të Tiranës. Në javët e fundit, Biblioteka Kombëtare e ka mbijetuar një gjendje përmbetje, që erdhi prej problemeve teknike. Godina i ka mbijetuar një zjarri, që e detyroi të ishte e paaksesueshme për lexuesit dhe po ashtu edhe shumë problemeve të tjera. Zyrtarët e saj vazhdimisht e kanë bërë hapur apelin e tyre dhe kanë treguar mundësitë e kufizuara të hapësirës dhe jo vetëm, por që gjithsesi duket se kanë rënë në vesh të shurdhër. Apele ynë ka qenë i vazhdueshëm që Piramida të lthehej në Bibliotekën Kombëtare, kuptohet

Prej pak kohësh apelojmë që kjo godinë (Lexo: QNK ose Piramida), duke marrë parasysh gjendjen katastrofike të Bibliotekës Kombëtare të ishte vend strehimi i saj dhe pse jo kuartieri kryesor i Bibliotekës Kombëtare. Në javët e fundit, Biblioteka Kombëtare e ka mbijetuar një gjendje përmbetje, që erdhi prej problemeve teknike. Godina i ka mbijetuar një zjarri, që e detyroi të ishte e paaksesueshme për lexuesit dhe po ashtu edhe shumë problemeve të tjera. Zyrtarët e saj vazhdimisht e kanë bërë hapur apelin e tyre dhe kanë treguar mundësitë e kufizuara të hapësirës dhe jo vetëm, por që gjithsesi duket se kanë rënë në vesh të shurdhër...

Një letër pa përgjigje dhe e ardhmja e Piramidës



me modifikimet e mundshme, anipse duke marrë parasysh se energjia kryesore në këto kohëra ka shkuar për ruajtjen e Godinës së Teatrit Kombëtar pakkush është kujtuar për Bibliotekën dhe ca më tepër për Piramidën. Do të ishte ndër të autoriteteve shqiptare që ta rishihnin memorandumun e tyre me Fondin Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit dhe nga ana tjetër këta të fundit të tregoheshin mirëkuptues për një drejtim të ri. Mbase juristët do të dinë të japin përgjigje më të arsyeshme se ç'mund të bëhet në këtë rast, por duken shenjat jo të mira për mos reflektim: që nga mospërgjigja e autoriteteve të Fondit, që nuk e kanë marrë shumë parasysh, qoftë dhe letrën e drejtuar nga bashkëkombasit e tyre.

Michael Granoff
Kryetar i Bordit të të Besuarve
Fondi Shqiptaro-Amerikan i
Zhvillimit
Nju Jork
SHBA

4 maj 2018
I ndëruar z. Granoff,
Po ju shkruajmë dy shtetas amerikanë me prejardhje hebraike dhe shqiptare. Ju drejtohem i detyrën tuaj si Kryetar i Bordit të Besuarve të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit.
Rreth një vit më parë filluam përmes Komitetit Amerikan të Trashëgimisë Kulturore [U.S. Heri-

tage Commission] një nismë private dhe të pavarur qytetare për të transferuar në Shqipëri Bibliotekën dhe Letrat e Prof. Dr. Norbert Jokl [1877 - 1942], qytetar i shquar hebre-austriak dhe linguist me famë botërore, i cili u shfaros gjatë Holokaustit.

Ishte dëshira e vetë Prof. Joklit që e gjithë pasuria e vet akademike t'i lihej trashëgimim popullit të Shqipërisë. Mirëpo ende sot testamenti i tij ka mbetur i paekzekutuar. Biblioteka dhe Letrat e Joklit ende ndodhen në Bibliotekën Kombëtare të Austrisë. Kjo është një lloj sikur krimi të vijojë të jetë duke u kryer.

Në përputhje me një traktat dypalësh SHBA - Shqipëri, ne i kemi kërkuar qeverisë sonë amerikane ndihmë që (i) pasuria e Joklit të përcaktohet si "pasuri me vlera të veçanta kulturore" për trashëgiminë tonë; (ii) të punohet me Austrinë për kthimin e pasurisë akademike të Joklit në Shqipëri, në përputhje me dëshirën e tij dhe (iii) të punojë me shtetin shqiptar për ruajtjen e pasurisë së Joklit me shkallën më të lartë të përkujdesjes dhe vëmendjes, me shpresë në një detyrë të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë [BKSH].

Në pikën e fundit, ne kemi ndjekur me vëmendje një nismë të kohëve të fundit në Shqipëri për ta transformuar ish-Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës [QNK] në një ndërtesë apo aneks modern të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, ku Pasuria Akademike e Joklit do të mund të ruhej e sigurt për brezat e ardhshme. Sikurse sugjeron përvoja jonë me ndërtesat e shumta të Bibliotekës së Kongresit, aneksit të ri të BKSH-së në Tiranë mundet edhe t'i vihej emri i Prof. Norbert Jokl.

Ndërkohë që kjo nismë vendore na gëzoi mjaft dhe u gatitëm ta mbështesim publikisht, mësuam nga ana tjetër të zhgënjyer se kryetari i bashkisë së Tiranës, z. Erjon Veliaj, nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me dy bashkë-drejtorët tuaj në Tiranë për ta transformuar ish-Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës në një inkubator për novatorizmin dhe sipërmarrjen për rininë.

Z. Granoff, ne ju kërkojmë me mirësi dhe respekt që ju ta pezulloni dhe ta anuloni këtë angazhim të Fondit Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit [AADF].

Faktorët që e bëjnë të domosdoshme një qëndrim reflektiv dhe të kujdesshëm nga ana tuaj janë të shumtë.

Së pari, sikurse e dini, inkubatorët të kësaj natyre përgjithësisht strukturohen apo ngrihen në zona të dëmtuara ose të lëna pas dore të një qyteti. Kurse ish Qendra Ndërkombëtare e Kulturës ndodhet pikërisht në qendër të Tiranës, as 50 metra larg nga Kryeministria.

Pse u dashkan investuar fondet tuaja të vlefshme atje, dhe jo në zona të lëna pas dore në periferi të Tiranës?

Së dyti, është e vërtetë se ndërtesa në fjalë fillimisht u projektua dhe u ndërtua si një Muzeum për Enver Hoxhën, ish diktatorin e Shqipërisë. Megjithatë, vlerat e saj simbolike tashmë janë tejkaluar.

Fill pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri, ndërtesa, sikurse vërejtëm, u shndërrua në Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës. Madje, gjatë një periudhe të caktuar, ndërtesa strehoi edhe zyrat e Agjencisë Amerikane të Informacionit [U.S. Information Agency] si edhe US-AID-in, sëbashku me stacione të rëndësishme televizive vendase. Për më tepër, përdorimi si sinonim i termit "Piramidë" është i pasaktë. Me të vërtetë, këqyrja nga lart e ndërtesës së QNK-së do të tregonte se ajo ka trajtën e shqipes, që sikurse e dini, është simboli i kombit shqiptar. Prandaj, e gjithë ideja se, përmes këtij projekti AADF-ja kinse po transformohej në një simbol të ish regjimit komunist në një simbol të sipërmarrjes kapitaliste në Shqipëri është më së paku e pavend dhe e papërtë.

Së treti, vetë ndërtesa fillimisht u projektua për muzeum. Prandaj, ajo mund të shndërrohet lehtë në një ndërtesë shtesë të Bibliotekës Kombëtare. Me të



GJ GJUHËSI

NGA BAJRAM SEFAJ

Para disa ditësh në Tiranë, në moshën 72vjeçare, mbas një sëmundje të gjatë e të rëndë, vdiq profesor Eqrem Çabej, pa dyshim albanologu dhe ballkanologu më i madh i të gjitha kohëve...

Eqrem Çabej u lind në vitin 1908 në Gjirokastrë, në një familje mesatare. Mbas shkollës fillore në vendlindje, arsimin e mesëm e kreu në Klagenburg të Austrisë...

...Në një qendër me tradita të forta e pasura shkencore e lingvistike, studimet albanologjike zinin një vend të spikatur në gjysmën e parë të shekullit të kaluar, kurse në gjysmën e dytë ato morën hov edhe ma të madh, dhe, në veçanti, në fillim të këtij shekulli (Kopitar, Gustav Majer, M. Lamberg, Krecqer, Jokli)...

Mbas kthimit në atdhe tok me bashkëdhëtarët e tij, po kështu shkencëtarët të vyeshtëm të kësaj fushe, Aleksandër Xhuvanin e Kri-taq Cipon, Eqrem Çabej boton një varg punimesh, artikujsh e trajtesash (shqyrtimesh) shkencore, në shumë publikacione (botime) e revista ndër të cilat në "Revue international des etudes balkaniques"...

Në nder të profesor Çabejt, që këto ditë pati 110-vjetorin elindjes, në organin "Jedinstvo" të Prishtinës, më datën 30 gusht 1980, në faqen 10, është botuar artikulli kushtuar shkencëtarit tonë të gjuhës pak ditë pas vdekjes së tij. Interesant është fakti që autori e botoi pikërisht në një nga organet më të njohura të kohës për shovinizmin dhe cinizmin e saj ndaj shqiptarëve...

Me rastin e vdekjes së Eqrem Çabejt

Vigan i albanologjisë dhe ballkanologjisë

Ky punonjës shkencor i palodhshëm e shumë prodhimtar, i cili la pas vetes një numër të pafund veprash shkencore nga fusha e albanologjisë dhe ballkanologjisë, pati për moto: "Historia e gjuhës është histori e popullit që e flet atë gjuhë".



Profesor Çabej punoi për çdo vit

Që nga viti 1936, kur botoi veprën e parë shkencore dhe deri sa vdiq, duke punuar si shkencëtar hulumtues, pothuaj çdo vit ai e pasuronte opusin e tij në me vepra të çmueshme me vlera të pallogaritshme. NB "Rilindja" e Prishtinës në vitin 1976 mbloodhi dhe botoi në gjashtë vëllime pjesën më të madhe e më të vlerët të krijimtarisë së plotë të këtij punonjësi të shquar shkencor...

shkencorë.

Para disa ditësh, si të thuash në prag të vdekjes, duke qenë në shtrat, Eqrem Çabej u përgjigj kërkesës së Televizionit të Prishtinës e dha deklaratën e tij të fundit publike ose porositin apo testamentin për të gjithë albanologët e rinj të ardhshëm e shkencëtarët e tjerë që do vijnë. Në këtë rast, midis të tjerave, ai tha: "Mendoj se në studimet që janë bërë dhe në ato që do të bëhen në të ardhmen në fushën e shkencave humane, d.m.th. në etnografi, gjuhë, histori, arkeologji dhe parahistori, ne shqiptarët do të nisemi nga fakti i padiskutueshëm se populli ynë është ndër popujt më të vjetër në gadishullin e Ballkanit. Kjo duhet të përbëjë premisën nga e cila do të nisemi, kjo tregon se populli ynë ka lidhje të ngushta me popujt e lashtë të gadishullit ballkanik... Tash lind pyetja se në ç'formë do t'i studiojmë këto çështje. Mendoj që si në shekullin e kaluar ashtu dhe në këtë të sotmin, në kërkim e tyre shqiptarët kanë qenë të cilruar nga shovinizmi, nga çdo frymë shovinizmi, nga çdo fanatizëm shkencor. Mendoj se kësaj rruge duhet të ecim përpara. Kjo rrugë është pozitive. Kjo vlen edhe për studimin e lidhjeve tona me popujt e tjerë ballkanikë. Por kur them se duhet të jemi të cilruar, kjo do të thotë të jemi objektivë, të humtojmë të vërtetat, por hulumtimi i së vërtetës nuk duhet përzmi me indiferentizmin, do të ndjekim objektivitetin shkencor, hulumtimet objektive, por jo ato indiferente. Kjo vlen për të gjithë..."

Vdekja e akademik Eqrem Çabejt, i cili në vendin e vet është shpallur mësuës i popullit, është humbje e pakompensueshme jo vetëm për shkencën e kulturën, por edhe për kombin shqiptar në përgjithësi. Vepra e këtij arkitekti të kulturës e shkencës do të jetojë përgjithmonë.

*Bajram Sefaj (Përkthyer nga serbishtja prej Esat Myftari)

luftës së dytë botërore. Pikërisht falë punës së palodhshme të Eqrem Çabejt, Tirana u bë qendër e albanistikës, dhe prej aty zëri i shkencës shqiptare do të dëgjohet jo vetëm në Ballkan por edhe në Europë e botë.

Që nga viti 1936, kur botoi veprën e parë shkencore dhe deri sa vdiq, duke punuar si shkencëtar hulumtues, pothuaj çdo vit ai e pasuronte opusin e tij në me vepra të çmueshme me vlera të pallogaritshme. NB "Rilindja" e Prishtinës në vitin 1976 mbloodhi dhe botoi në gjashtë vëllime pjesën më të madhe e më të vlerët të krijimtarisë së plotë të këtij punonjësi të shquar shkencor. Ndihmesën e tij të paçmueshme për albanologjinë e ballkanologjinë Eqrem Çabej e dha edhe duke bashkëpunuar në shumë takime shkencore ballkanike, europiane e botërore që merreshin me këto çështje. Rëndësi të veçantë kanë ligjëratat e tija të mbajtura në katëdrat përkatëse të Universitetit të Prishtinës dhe atë të Shkupit. Prandaj mund të thuhet lirshist se të gjithë albanologët e gjallë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë kanë qenë nxënës të tij



Faksimilja e artikullit të botuar në cirilikë në faqen 10, më 30 gusht 1980 në "Jedinstvo" të Prishtinës

vërtetë, përdorimi i saj si një bibliotekë për popullin e Shqipërisë do të ishte diçka e përkryer. Përse vallë AADF do të hidhej dhe angazhonte veten në një nisimë biznesi e cila, edhe pse me qëllime të mira, në vetveted do të cenonte ruajtjen dhe shpëtimin e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë për të tashmen dhe të ardhmen?

Së katërti, sikurse mund ta dinë, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë ka vuajtur qysh nga mesi i viteve 1980 prej mungesës dramatike të investimeve, vëmendjes dhe përkujdesjes nga ana e të gjitha qeverive shqiptare në vijimësi kronologjike. Si rrjedhojë, ndërkohë që hapësirat e saj librare dhe institucionale kanë mbetur të pandryshuara, ose më saktë, janë reduk-

tuar në mënyrë drastike, madhësia e koleksioneve të saj si dhe vëllimi i librave të ruajtura është rritur në shkallë eksponenciale. Për pasojë, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë përballet me nevojën kritike dhe urgjente për hapësirë raftesh dhe magazinimi, si dhe për vend të përshtatshëm. Zgjerimi i saj duke përfshirë edhe ndërtesën e ish Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës do të ishte, me të vërtetë, një zgjidhje e përkryer.

Së pesti, ndërtesa e ish QNK-së u ngrit me djersën dhe gjakun e mbarë popullit të Shqipërisë, që nga Tropoja në Veri e deri në Gjirokastrë në Jugë. Rrjedhimisht, vendimi i qeverisë qendrore për ta zhveshur apo hequr ndërtesën nga varësia e saj në favor të bashkisë së

Tiranës ngre prima facie shumë pikëpyetje të ligjshme. Me të vërtetë, çdo qytetar shqiptar mund të ngrinte me mirëbesim një padi administrative për ta kundërshtuar me sukses vlefshmërinë e këtij transferimi dhe për të kërkuar rikthimin e ndërtesës në pronësi të Ministrisë Shqiptare të Kulturës. Qartazi gjasat janë se e gjitha kjo mund të shkëlzohej deri në një përplasje juridike me rezultat së paku të paqartë, por që gjithsesi, do të mund të cenonin objektivisht emrin e mirë dhe reputacionin e AADF-së.

Së fundi, është fakt i mirënjohur se, edhe pse gjuha dhe kultura shqipe janë ndër më të lashtat në Europë, interesi akademik për studime shqiptare në

universitete perëndimore paraqet rënie dramatike. Prandaj, mbetet detyrim i ngutshëm për institucionet përkatëse në Shqipëri marrja e vendimeve strategjike për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore të kombit të tyre për brezat e ardhshëm. Transformimi ndërtesës së ish-QNK-së në një pjesë funksionale e ruajtëse të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë të kushtuar konservimit të kësaj gjuhe dhe kulture të lashtë për Mijëvjeçarin e Tretë, dhe mundësisht, emërtimi i saj pas Prof. Dr. Norbert Jokl, kthehet vërtetë një akt tejet të ngutshëm dhe fisnik.

A do ta mbështesnit ju dhe Bordi tuaj i të Besuarve këtë nisimë?

A do ta rishqyrtonit ju dhe Bordi tuaj i të Besuarve nisimën e inkubatorit?

Për dijeninë tuaj, ne do t'i drejtohem edhe Kryetarit të nderuar të Bashkisë, z. Vella, me kërkesën që ai t'ia rikthejë qeverisë qendrore dhe popullit të Shqipërisë dhuratën " ndërtesë të ish-QNK-së.

Lutem jeni të lirë të lidheni me ne nëse do t'ju nevojitet më shumë informacion.

Ju falenderojmë për vëmendjen dhe mirëpresim reagimin tuaj sa më sipër

Sinqerisht, Benjamen Neumann Agron Alibali

V

VEPRA

Teoria mbizotëruese nën dritën e së cilës mund të shihet tregimi i Sotir Andonit është ajo formaliste, pasi si prozë plot lëng jetësor dhe me një pasuri gjuhësore të larmishme, edhe pse kjo i shkon më përshtat poezisë si forma më e lartësuar e letërsisë, tregimet e S. Andonit s'janë gjë tjetër vetëm se një prozë poetike...

Një rrëfimtar që fle, harruar

NGA ANDON ANDONI

Edhe pas 15 viteve si ka ikur nga kjo botë e të gjallëve, thuajse i harruar në lëmin e studimeve letrare edhe pse shpesh në të shkuarën është përmendur "si një rrëfimtar safi" dhe "pasues i prozës së Kutelit" shkrimtari apo më saktë proza e tregimtarit Sotir Andoni, mund të përbëjë sot një gjeth të vyer për studimin shkencor dhe aq më shumë për kritikën letrare praktike. Por ne si lexues, kemi nevojë t'u kthehemi shpesh "harresave" të tilla, jo më për shkrimtarin, pasi ai nuk ka më nevojë për ne, por ne kemi nevojë për lëçitje brenda krijimit që ai dhe brezi i tij lanë pas.

Në këtë shkrim do ndalemi në disa prej tregimeve të krijimtarisë së tij të parë (deri në fillimin e viteve shtatëdhjetë të shekullit të shkuar) të librave "Maleve në shënëndre" 1957, "Tregime nga Morava" 1960, "Kur merrnim fluturim" (1967) "Dasmë ë çuditshme", "Tregime të zgjedhura" "Toena" 2005, duke i parë ato nën frymën e një teorie pozitiviste, në ndikimin e mjedisit ku u formua shkrimtari dhe kohën e krijimit të këtyre librave, pasi në krijimtarinë e mëvonshme, ajo vjen dhe zbehet nën trysinë e goditjeve të njëpasnjëshme që pësoi autori për hir të diktaturës, dhe thuajse u tërhoq ashtu sikurse bënë dhe miqtë, e njëherazi ustallarët e tij, M. Kuteli e më shumë L. Pogradeci në kohën e ndërtimit të socializmit "me forcat tonë".

Teoria mbizotëruese nën dritën e së cilës mund të shihet tregimi i Sotir Andonit, është ajo formaliste pasi si prozë plot lëng jetësor dhe me një pasuri gjuhësore të larmishme, edhe pse kjo i shkon më përshtat poezisë si forma më e lartësuar e letërsisë, tregimet e S. Andonit s'janë gjë tjetër vetëm se një prozë poetike.

Kjo gjuhë, shpesh ka himnizuar dhe ka tjetërsuar realitetin social shoqëror. E ka "rrëfyer" jetën më të bukur nga sa ekzistonte. Ajo nuk ka shprehur të zakonshmen dhe të përsëritshmen e jetës së karaktereve dhe personazheve në tregime, por jetën me një "ritëm e tingëllim të çuditshëm" por duke mbetur një prozë letrare plot lëng.

Ai lindi në Zëçisht të Korçës (1925-2003) në familjen e një tregtari dhe mërgimtari që kishte kaluar dy herë Atlantikut, drejt tokës së premtuar Amerikës, përpara luftës së dytë botërore, por që kishte preferuar të mbetej një mëmëdhetar në vendlindjen e tij ku krijoi familje e ku do të vinte në jetë dhe djali i tij i dytë Sotiri.

Në një fshat që numëronte dhjetëra kurbetçinj në malet e Athosit, si pjesë e atyre "tremijë mërgimtarëve që Shahin Kolonja kishte regjistruar në fillim të shekullit të shkuar" e që jehona e bërmave dhe zhgëjmave të tyre, vinte në tregimet e tij në formën e Kolesë Stefanit tek "I handakosuri",



"Kandili i shuar", dhe "Ligor Dodani".

Mësimet e para i mori nga mësuesi i fshatit një njeri i shkolluar në vendet gjermanike, dhe që vinte në Toskëri prej veriut të Gjakovës, tek i cili shkrimtari i ardhshëm kish të gjetur shëmbëlltërinë e dijes dhe të leximit. Çamarrok, siç e rrëfen veten përmes unit artistik në mjaft prej tregimeve të tij, ai do ishte njeriu që do furnizonte me ushqime të përndjekurin e Kryengritjes së Fierit, Kostë Cekrezin, të afërm nga fisi, që përkthente, i arratisur në malin e Moravës, "Kontin e Monte Kristos" duke ia vënë në duar shkrimtarit të ardhshëm në fashikujt e dorëshkrimeve të tij.

Porse ajo që do ta mrekullonte më tepër ishte toskërishtja në rrëfjetat e Mitrush Kutelit të cillin më vonë do ta kishte mikun e zemrës dhe do ta quante nëpër letërkëmbimet e shumta "usta".

I rritur në një mjedis të shëndetshëm dhe në një jetë fshatare të ng-

ritur me nikoqirllëk, ai do të kujtojë më vonë botën e fëmijërisë dhe rinisë së tij të hershme, në tregime

I rritur në mjedis rural

I rritur në një mjedis të shëndetshëm dhe në një jetë fshatare të ngritur me nikoqirllëk, ai do të kujtojë më vonë botën e fëmijërisë dhe rinisë së tij të hershme, në tregime të tilla si "Gazet dhe helmët e fshatit tim" nga vëllimi "Maleve në shënëndre" 1958 "Lorka" nga vëllimi "I dërguari nga klasa" "Këngët e rinisë së parë" nga vëllimi "Dasëm e çuditshme" etj. Të gjitha këto, të marra së bashku dhe të vështruar edhe në dinamikën e jetës së tij social shoqërore deri në fund të viteve '90, do të na mundësojnë të hedhim dritë rreth oshilacioneve të krijimtarisë së tij dhe për më tepër për të dalluar letraren nga "partishmëria në vepër"

të tilla si "Gazet dhe helmët e fshatit tim" nga vëllimi "Maleve në shënëndre" 1958 "Lorka" nga vëllimi "I dërguari nga klasa" "Këngët e rinisë së parë" nga vëllimi "Dasëm e çuditshme" etj. Të gjitha këto, të marra së bashku dhe të vështruar edhe në dinamikën e jetës së tij social shoqërore deri në fund të viteve '90, do të na mundësojnë të hedhim dritë rreth oshilacioneve të krijimtarisë së tij dhe për më tepër për të dalluar letraren nga "partishmëria në vepër"

Fabula dhe tjetërsimi i saj artistik në subjektin e tregimit

Ashtu sikurse pranohet nga njohës të krijimtarisë së S. Andonit ai ishte një "Rrëfyes i jashtëzakonshëm i trillimeve krijuese, përblojtur mundimshëm në mokrat e përjetimeve dhe fantazive të veta.... tregimin e sapopërfunduar, e rrëfente me bukur sesa e shkruante"⁸

Një element thelbësor për tregimin andonian duket se është subjekti i tregimeve.

Me "një efekt tjetërsues tek fabula"⁴ dhe i kujdesshëm që fjalë e parë e tregimit të flasë e kumtojë me të fundit si të tillë, tregimet janë një koherencë e plotë përmes elementeve të fabulës dhe shumësisë së "materialeve". Le të sjell një shembull nga tregimi "Sefedin Komiti, Sefedin Labi" nga vëllimi "Fletë të kuqe Qershie".

Ja fabula: Sefedin Komiti, i porsa martuar hyn në sherr me beun e fshatit se ky i fundit ia rrëzoj oxhakun e shtëpisë, ia lëviz gurin e sinorit në bahçe dhe ndërtoi një mulli ngjitur më shtëpinë e Sefedit duke ia lëshuar ujrat e jazit nëpër obrorr...

"Epo dëgjo o bej! Si e ke ni sur zotëroto, do vish gjer në jatak të më kërkosh edhe nusen time...po më mirë na këtë që të jap unë dhe vajtsh në të satëmë..."⁵

Dhe doli komit e kaçak ma-
leve.

Kaq. Një fabul që na kumton një histori mëse të rëndomtë konfliktesh të paprera deri në ditët e sotme dhe që bashkëshoqëronë klasa e sisteme të shoqërisë.

Tashmë mbete në dorën e krijuesit që të tjetërsojë këto element të fabulës në një **subjekt letrar** për të përftuar një krijim të vërtetë dhe që me pak fjalë, është ky:

Na jepet Sefedin Komiti në moshë "tetëdhjetë" i ndodhur në sheshin e fshatit ditën e festivalit, ku "buhisinin sazet e hidhej vallja... Thonë se iu kujtua rinia e tij e hershme kur

mbante fustanellë prej komiti...⁶ kemi kështu "transferimin e materialeve, zhvendosjen e tyre të përkohshme" po bëhemi gati të pranojmë paraqitjen e ngjarjes apo thebin e saj përmes fabulës së mësipërme. Narracioni dhe gjuha e mjetëve shprehëse të saj, na fut në fabul, por vetëm kjo, sado bukur dhe elokumente të rrëfëhet, nuk na kumton e për më tepër nuk na ngazëllen me ndonjë efekt emocional e përjetues pas leximit të saj.

"Por pas dy vjet komit e kaçak malesh më pushkë krahut dhe me shpirt ndër dhëmbë.... mësoi se Italia ishte shtruar në Vlorë e nuk donte të tundej. Këtu më ke, pat thënë Sefedini dhe me pushkë krahut bënte hesap të zbriste asaj Labërie për nder e për trimëri. Por më parë se të nisej ju mbush mendja të shkonte një natë në shtëpi"⁸

Një fjali e vetme që shënon kthesën në tregim.

Vetëm kaq pak radhë dhe ndjejmë se tashmë ka filluar efekti i defamiliarizimit të fabulës deri në momentin përmbyllës që ky defamiliarizim do shtrihet më së tej në elementet e realitetit jetësor të tjetër-



suar artistikisht. Ende nuk jemi në rrjedhat e një narracioni dinamik apo një dinamikë e fundme e zgjidhur. Jemi në "një lojë fjalësh dhe efektesh të tjera"⁹ që receptuesin, lexuesin, e bën të mbete pezull se, ç'do ndodhë po u ktheje në shtëpi dy vjet larguar dhe kur "bijtë e hasmit mbanin vesh e përgjonin kur të kthehej ndonjë natë tek nusja e t'i bënin gjëmën"¹⁰, "duket se realiteti i fab-

P

POEZIA

Përkthyesi është një ihtar i poezisë së bukur dhe beson se njerëzit që nuk i lexojnë mjeshtrit e poezisë humbasin pa fund...

ANONIM JAPONEZ

DY QERSHITE

Dy qershi të dashuruara,
lindur larg njera-tjetres,
shiheshin, po nuk arrinin të prekeshin dot.
I pa një re, që i erdhi keq dhe qau nga dhimbja;
i tundi gjelhet e tyre, po kjo s'mjaftoi.
Qershitë nuk u prekën dot.
I pa një stuhi, që prej dhimbjes uletiu
dhe ua tundi akoma më fort degët.
Po as kjo s'mjaftoi.
Qershitë nuk u prekën dot.
I pa një mal, që u drodh nga dhimbja,
aq sa tronditi dhe trunget e tyre,
por dhe ai kot u lodh.
Kot.
Qershitë nuk u prekën dot.
Reja, stuhia dhe mali nuk e dinin
që nën tokë,
rrenjë e qershive
ishin pleksur në një përqaftim të pambarim.

BLAGA DIMITROVA


DASHURIA

Kam humbur ecjen e shkujdesur,
të qeshuren krenare gjithashtu,
po dhe heshljen e butë të shpirtit,
freskinë e veshtrimit kulturë.
Gjumini?.. Arralisur dhe ai. S'dihet ku.
I humba rrugët që më thërrisnin,
humba rebelimin,
të papritur, linqijt e këngëve,
të gjitha i humba
dhe lirinë.
Vërtet, me e shpenzuara e botës jam,
po dhe më e pasura :
kam dashurinë.

EUGENIO MONTALE

KAM ZBRITUR
I MBESHTETUR TE TI
TE PAKTEN NJE
MILION SHKALLE

Kam zbritur, duke të dhënë krahun, të paktën një milion shkallë
kurse tani që s'je, në to ka vetëm zbrazësi.
E shkurter paska qenë rruga jone e gjatë,
imja vazhdon akoma, po kur s'je li
s' më duhen më vendtakimet,
as koha, pa të kurthet dhe dështimet
e humbësit që kujton se realiteti është ai që shikon.
Kam zbritur miliona shkallë, mbështetur te ti,
jo sepse dihet që katër sy shohin më mirë nga dy.
I zbrita pa frikë, se e dija, që nga bebëzat tona të syve,
dhe pse të mjegulluara, të vetmet që ma gjenin rrugën
i kishe ti.
Uniforma e sotme është durimi,
medalja s'është veçse ylli i mjerë i shpresës,
varur poshtë zemrës.
Jepet
për braktisje flamuri,
për akte trimërie ndaj mikut,



Pasiguria e poetit-Giorgio de Chirico

për tradhëti sekretesh që s'kanë më vlerë
dhe për moszbatim të çdo lloj urdhëri.
Ta akordojnë
kur s'ndodh më gjë,
kur gjësimet e predhëve janë shuar,
kur armiku është bërë i padukshëm
dhe hija e riarmatimit
nxin gjithë qiellin.

JOSEPH BRODSKY

ISHULLI PROCIDA

Gji i humbur. Njëzetë barka të vogla me vela, jo më shumë.
Rrjeta të nderura si çarçafë, që thahen.
Perëndim. Disa pleq në bar shohin ndeshje, s'duan gjumë.
E kalterta me blunë e delit lidhen fort e s'ndahen.
Një çafkë kap horizontin më shpejt nga erësimi.
Pas orës tele gjithë bregu është i shkretët.
Bluja perëndimit ia fshin në qiell kufirin,
tej tij shkrep një yll, që t' kujton se ka jetë.

WISLAWA SZYMBORSKA

TE PAKTEN PER
NJË ÇAST

...Nuk ka jetë
që të paktën për një çast
të mos jetë e pavdekshme.

SHEKSPIR

S' DI SE KUR, PO...

...kur nuk do të jesh më
pjesë e vetes sime,
nga kujtimi yt do të heq
gjithë copëzat me yje.
E megjithatë,
ai qiell do të jetë aq i bukur,
saqë e tërë bota,
do të dashurohet me natën.


KONSTANDINOS KAVAFIS

NJË I HARRUAR

Brendësi kafeje. Zhaurimë.
Në një tavolinë rri veçuar
një i moshuar, perkulur mbi gazete.
Pranë, asnjë shok.
Dhe mendon aty, n'al' pleqëri të trishtë,
sa pak e ka gëzuar jetën,
kur ish' e bukur dhe e brishtë,
kur fliste lirshëm e me rrjedhshmeri,
si dinle të fliste dikur ai.
E ndjen që shumë ka rënë, e sheh, e di.
Koha e rinisë?
"Ajo që që tje".
O hapësirë e shkurtër, përse kaq shpejt më le?
Befas për urtësinë mendon, që e ka tallur e mashtruar.
Dhe ai, tërësisht (çfarë çmendurie!) e kish besuar:
"Ke kohë plot, kohë ke dhe nesër,
mos u mendo kaq shumë!", thosh ajo,
mirë ke për t'ia kaluar, mos dysho!
Kështu gëzimet një nga një i bëri fili,
vrapin e ndali. Në vend, si mjaft të tjerë, mbeti dhe ai.
Tani kujton me radhë humbjet
dhe
çdo rast
lingull përqeshjeje e talljeje i duket se mbart.
ç'marrëzil..

I zhytur në mendime, nën atë shi kujtimesh
është shushatur fare.
S'i vete mendja për kafe.
Mbështet kokën n' tavolinë dhe ...
i harruar,
rri
e
fle.

Shqipëroi Harallamb Fandi



T

TREGIM

Shumë e kursyer në mjetet e saj shprehëse, por autorja është njohëse e mirë e kanoneve të tregimit të shkurtër...

Gjallëria ironike

NGA VALBONA ZHUPA

Çdo ditë ishte e para. Dikur shkruheshin këngë për luftën, dashurinë, qeveritë e kriza sociale. Duke sikur njerëzit nuk do të ishin edhe për shumë kohë në këtë planet.

Ti je ulur përballë meje dhe hesht. U bënë disa minuta. As unë nuk di çfarë të them. Të shoh me ngulm, por nuk e ke mendjen. Je mirë, me një këmishë të bardhë, flokët të janë shkatërruar nga syzet që ke vënë pa rregull mbi kokë, ke fiksuar vështrimin dhe përzien kafen me qetësi. Më bën nevrik. Dua të them diçka, por me mbyt ankthi. Është gati për shi, retë gati sa nuk më hyjnë në kraharor, koha kalon dhe prapë s'më vjen asgjë. Jam bosh. Nga kyçi i djathtë i dorës të duket një verore.

Si më the? Duhet të nxitosh të shohësh sa më shumë filma, që të ngopesh me ëndrra. Ç'më duhen ëndrrat të pyeta? Të jesh në gjendje të jetosh jetën. Ufff, këto lloj këshillash nuk më hynin në xhep. Asnjëherë s'më ishte dukur vetja ëndërrimtare, përkundrazi ndjehesha e trishtuar. Në fund të fundit njerëzit janë shumë më pak ndryshe nga njëri tjetri se sa mendohet.

Ti vë syzet se të vret dielli i nxehtë që del befas si kapada, duke më dhënë një kokëdhimbje të heshtur.

Ndërsa unë mendoj se duhet të kisha qenë më trime. Pse e kisha nënvlerësuar peshën e asaj që ndjeja duke përshpejtuar rrjedhën e saj?

Përballë teje, e ndjej se kam bërë dhe një gafë tjetër, të jam mburrur.

Tek e fundit, çfarë shansesh kisha? Të braktisesh apo të isha e lumtur?

Pavarësisht paqëndrueshmërisë dhe shembujve kundër në dukje, askush nuk kishte arritur të ma davariste ndjesinë e trishtimit.

Ashtu si sot, dhe atë ditë nuk ishte as ftohtë as ngrohtë. Ishte fund maji. Ajri i lagësht nga shiu që kishte rënë më jepte një gjallëri ironike, saqë kisha ndërtuar disa ushtrime përqendrimi vetëm të vija në terezi.

Syprina e ujit midis asfaltit të çarë më jep një kënaqësi idilike.


Po shkoja në punë. Mu desh ta dyfishoja përkushtimin tim ndaj realitetit. Ja ku dola nga tema. Se këtë bëj unë, radhis elementë pa lidhje dhe hamendësoj hipotezat që i ngre vetë me mendje.

Por telefonata jote ma ndryshoi humorin.

Më the që kishe ardhur në qytet. Njiheshim prej disa vitesh, asgjë e rëndësishme, dy kafe aty- këtu, duke rëndur pas lajmit, me premtimin që një ditë do të rrinim seriozisht.

- Do takohemi?

Nuk u përgjigja menjëherë. Rrugët ishin



të shkreta. Ti je trupmadh, i ëmbël, i heshur, me flokë të dendura e faqe të zbehta. Ke një lëkurë të brishtë dhe një mjekër të shpërndarë pakujdes.

Fytyra, me një shprehje të amshtë të tregon mosbesues për ato gjëra që duken të rëndësishme, por indiferenca jote mbetet pezull pikërisht mu aty, tek gjërat e pazakonta. Duart e tua thonë se nuk kanë prekur kurrë një punë të rëndë.

Çdo bëj me ty? Dikur ja njihja vetes këtë huqin hilacak që më kishte tradhtuar me qindra herë. Do mërzitesha.

Por gabova. Thjeshtësia me të cilën u përpoqe të më ndillte të dilja më mbushi me padurim.

Ti jetoje në një univers paqeje dhe drite, ndaj kur u shfaq me vonesë poshtë shtëpisë time, ndriçoja e tëra dhe unë.

Me atë zërin fundor e mospërfillës më pëshpërite: "Më fal që u vonova, por tani ja arrita të vij. Si je ti?".

Për vete mu duk sikur po pluskoja në një përbërës të lëngshëm, mbushur me avuj dhe erë sapuni.

- Unë jam mirë - thashë e qetë. Do ikim? Disa miq më prisnin në një lokal të vogël, që më pëlqen të shkoj dy tre herë në muaj.

Rrimë jashtë, në oborr, pimë nga një gotë, e flasim si të hallakatur mbi çështje që nuk

na interesojnë. Psh. politika, ministrat, korruptioni, derisa fikemi nga alkooli e përfundojmë duke bërë thashetheme për dashnorët e tyre antipatike.

Po atë natë, na hipi një neps për bar. Ti nxore kartëvizitën ku mezi lexohej, emri, mbiemri, gazetar, free-lancer. Pastaj the, - "Kam një bli në oborrin e shtëpisë". Shpërtheu e qeshura. "Dhe unë kam një vazë në kuzhinë", mendova.

- Si ndjehesh? - e pyeti dikush nga miqtë e mi. Të jesh i famshëm e kam fjalën.

- Po ja, njerëzit më njohin e thonë - shikoni, ai aty është gazetari filan, është ai që fjalët i dalin me aq mjeshhtëri, e nisi të qeshë".

- Mos u bëj fëmijë.

- Ti ke shkruar për Berlinin, si është ky proces? - vazhdoi mikun.

- Cili proces?

- Procesi i të shkruarit. E di që artistët janë gjithmonë në siklet kur flasin për punët e tyre.

- Eh, çfarë artisti jam unë?

- Mua më pëlqeu vërtet ajo që kishe shkruar. Nuk kam qenë kurrë aty, por pasi lexova "short story-n" tënd u tundova shumë. Pas kësaj, ky tipi i kërkoi një autograf.

- Ke një penë? - e pyeti. Ti mohove me kokë.

- Një shkrimtar pa penë?

- Po. Një shkrimtar pa penë.

Na tregove gjerë e gjatë për udhëtimin në Berlin, ku kishte shkuar për dy ditë e kishte ndenjur katër muaj, në një dhomë të ngushtë me qiraxhinj pijanecë, shumicën e kohës pa para, vetëm e vetëm ti provoje vetes se mund t'ja dilje. Mu duke bujar. Bujar e pa lakmi, i zhytur në udhëtime të papritura, e në dëshira të befta.

Dhe - vazhdonte kuriozi - Ja dale? - Jo, puna është se unë u bëra serioz. Fjalët buronin, ato morën formë dhe forma u bë e plotë e pas një jave e kisha përfunduar tregimin. Ishin dhimbja, trishtimi, gëzimi që i dhanë jetë atyre fjalëve. Në fund u bëra serioz.

- Që do të thotë? - pyes unë.

- Nuk e di, që fjalët shkatërrojnë gjithçka e dashur.

Mu duke ironik.

- Por vjen një moment që duhet të zgjedhësh mes jetës dhe fantazisë- këmbëngula me qetësi.

Për drej kjo bisedë na u ndërpre. Lokali do mbyllej.

U çam të përgjumur, dhe u drejtuam në heshnje drejt "The source" (burimi), një lokal sqimatar, pordhac, plot me drogaxhinjsh, me të cilin atë natë na lidhte një bashkëfajësi dyshuese.

Kur hymë brenda, na printe një marrëveshje shqisash.

Pasi fytira të njohura nisën të shfaqeshin, grupi i shpërbë. Ndërsa po shkoja në tualet, më ngjitet një djalë lëkurë zeshkët që më dërdëlliste gjëra të pakuptimta. E kapa veten duke i buzëqeshur, sa për t'i treguar se megjithëse as e kisha idenë kush ishte, o më dukej i sjellshëm, me atë plotshmëri fizike ku ndonjëherë lëshonte një kërcitje ledhatuese të buzëve, ose mbase edhe po më tundonte seriozisht.

Shpejt, një dorë e fortë më kapi nga krahu e më tërhoqi me shqetësim. U ktheva e oh zot, ish i dashuri im qull nga djersja, pak i dehur sigurisht në një gjysmë-errësirë që më kujtonte dhomën e tij të gjumit, një atmosferë e lagësht dhe e zymtë. "Ç'bën këtu?" - më tha.

- Ti ç'bën këtu, - ju lëshova.

Doja patjetër dritë. Hodha sytë nga ti. Dhe ishte sikur po i hidhja sytë në një tablo në muzeun e Pradës. Ai imazh yti aty që më ftonte me dorë më dha një dehje celebrale, saqë çdo fjalë e ishi-tim u treg.

- Po iki - i thashë, e mbyllim këtu, jam e shoqëruar.

U largova hijerëndë disi e krisur brenda. Për pak sekonda mu kujtuan disa imazhe të shkuara. Ai (eksi) nuk dinte as të urrente as të donte, dhe për aq sa ndjenjë ishte treguar jashtëzakonisht i mirë dhe i gjindshëm. Goxha përkufizim.

I dashur, nuk di si të falënderoj që je tre tavolina më tej. Po të shoh, je duke kafshuar buzët se po flet me një bukurroshe dhe unë akoma s'kam vendosur çdo të bëj me ty. Ah çfarë paqe e trishtuar.

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte e dobët, madje tejet poshtë parashikimeve tona. Shkrimi kryesor iu la Gjon Markut, që ia kishte kushtuar artikullin e tij Gjon Gazullit. Sipas autorit, ky personalitet që do të ishte ambasadori i Skënderbeut nuk vinte nga hiçi. "Pal Gazulli ishte rektor në shkollave të Republikës dhe në një dokument, që ruhet në Arkivin e Dubrovnikut, e që daton në vitin 1442, thuhet se Dhoma e Vogël e Dubrovnikut kishte vendosur të merret në shërbim Pal Gazullin, vëllain e mësuësit Gjon Gazulli, si mësuës dhe rektor të shkollave të qytetit për dy vjet 1442-1444..." Në formën përshkuese të autorit, ai mbetet

nga njerëzit më të njohur. Shkrimi tregon impenjimin e madh të autorit për trevat e veriut dhe sidomos atë ku ai vetë jeton.

Autori shkroi sërish diçka për teatrin por duket se tashmë gjithçka po fashitet frikshëm. Ai vazhdon mendimin e tij që "Teatri Kombëtar duhet të qëndrojë atje ku është. Tirana e kullave ka vend plot aty ku po synon të bëhet apo në Tiranën moderne që po planifikon të marrë jetës apo pas Bulevardit të ri. Një referendum i qytetarëve mund ta zgjidhte shumë më lehtë këtë rebus, që na ka kapur, por nga ana tjetër do bënte për herë të parë që qytetari të merret në dorë



ligjërisht fatin e një vepre të kryeqytetit të shqiptarëve...". Në qëndrimin e tij, autori nuk ka dashur të bëjë protagonistin, që po provojnë të bëjnë shumë njerëz në ditët e fundit. Ag Apolloni na solli një intervistë të gjatë të cilën e kish ndërtuar për Primo Shllakun në organin e tij të shtypit. Pak patetike dhe i kishte dhënë mundësinë Primos, që të nxirrte disa dhe persekutimin e tij. Redaktori ka përzgjedhur disa pjesë të intervistës, që i ka sjellë për publikun tonë dhe shtoi se: Autori tregon disa koncepte të krijimeve të tij, por edhe pikëpamjet mbi letërsinë dhe jo vetëm... I mungon pak modestia këtij personazhi ose është ide e redaktorit!

Redaktori solli një përkthim nga një intervistë e Paris Review të Harold Pinter.

Duhej të punohej më mirë dhe redaktori ka faj, që nuk u kujdes pak më shumë për këtë autor kaq të madh të dramës. "Është thjesht instinkt. Perdet bien kur ritmi më duket i drejtë kur aksioni të thërret tamam për një fund. Unë jam shumë i dhënë për linjën e perdevës dhe uljen e tyre në kohën e duruar". Roland Gjokës i ishte lenë pjesa e poezisë dhe evidentoi një linjë të hollë për qytetin më të zhurmshëm të botës... që kishte nevojë të trajtohej pak më gjersisht...

Layout kishte punuar gati në një kohë rekord dhe shumë efikase.

Gjallëria ironike

→ Vijnë nga faqja 19

Vetëm kur arrita tek tavolina u qetësova. Nxora paketën dhe të zgjata një cigare.

"Besoj tani jemi në rregull" - të thashë. E bëra e u ndjeva e lehtësuar. Lindur dhe rritur në një provincë, pjesën tjetër të botës ti e kishte njohur vetëm nga leximet e udhëtimet.

Jeta nëpër ato vende është e egër. Vetëm më kishte thënë se nëse do të rrije aty, do gjeje një vajzë të re dhe të ashpër dhe pa asnjë emociion do ta zhvirgëroje me atë pjekuri të parakohshme që ta fal provinca. Do martoheshe pastaj...

Ktheva me fund gotën që kisha përpara dhe porosita dhe një tjetër. Ajri ishte zhdukur bashkë me dritën.

Më erdhi në mend që dikur kisha fjetur më një tip të panjohur, që herë mërmëriste nëpër dhëmbë, herë dukej sikur nuk ishte aty.

Meshkujt që dëshiroj janë gjithmonë meshkuj ëndërrash. Rrallë kam takuar të tillë, por me kohë gjykimi ka ndryshuar. Dikur i njihja nga heshtja, tani për aq sa më kujtohet, sa më shumë më tërheqim aq më tepër bëhem e paqëndrueshme.

Ndjeva se po përpiesha nga një natë e turbullt. "Jam e krisur" - , mendova. (nëse, përsëri po shmangem nga tema).

Dalëngadalë miqtë po largoheshin. Mbetëm vetëm ne.

U quam. Një drojë e trishtuar po më kërruste hapat. Kishte nisur shi. Nuk morëm taks.

Shtëpia ime ishte diku mbi një të përpjetë, tërë baltë. Kur arritëm, sa nuk u rrëzuan në llucë. Ishte e vështirë të bëje përpara duke ndenjur të dy bashkë. Njëri duhej të ndalonete. Unë rrija ngjeshur. Ashtu kaluam.

U ngjitëm në shkallë. Përfituam nga hapësira e sheshpushimeve. U puthëm.

Puthje me shije bari. Derën e hapa me vështirësi. Hymë brenda.

- Pikturat e tua janë këto?

- Po.

- Pra ti je artiste?

- Pikturoj për vete.

- I ke ekspozuar ndonjëherë?

- Jo.

- Pse?

- Jam frikacake.

- Po me ty? Cfarë ndodh me ty? Pse je kështu, i paqetë? Je përherë në lëvizje, çfarë drejtin shkruan te ai bllok? Dua të di çfarë mendon kur shkruan, për kë shkruan?



Ilustrim Wassily Kandinsky

- Kur shkruan, e jeton kohën me ndjenjen që nuk do ja dalësh, që do e bësh keq, sikur të mos jesh në gjendje të thuash atë që me të vërtetë do doje të thoshe. Duke u përpjekur të mbledhësh së bashku pjesë jete të panjohurish, fjalë të pathëna, ndjesi të pajetuara, që i ëndërron, i urren, i dëshiron, i ndjell, i përcmon, jetën tënde, të përditshmen. Ato që të kujtohen dhe ato që harron. E pavarësisht se i jeton ditët e tua në një konflikt të vazhdueshëm me veten, vazhdon ta bësh, çdo ditë nga pak, duke besuar gjithmonë e më shumë në të.

- Edhe?

- Pak rreshta nga këto shndërrohen në tregime. Dhe nuk mund të bësh pa i lexuar, dhjetëra herë. Kush e di nëse kjo është pjesë e praktikës së një shkrimtari të mirë, nuk e di. Por unë dua ta lë çdo gjë të shkojë si duhet, si më vjen. Në mënyrën më të natyrshme. Lexoj për të kujtuar ku kam gabuar, e nëse mund të përmirësohem. Lexoj edhe shpesh qaj e qesh për një histori që varet vetëm nga unë. Frika e të gabuarit rri aty, por asnjëherë si në ato momente, unë i jap vetes lirinë për të besuar se, pas gjithçkaje, është pikërisht ashtu si duhet të jetë.

- Kurse unë dua të di çfarë dreqin më ke bërë?

- Si?

- Të marrë erë në ëndrrat e mia.

- Cfarë ere kam?

- Erën tënde, atë që ke tani, të ëmbël, të përzierë me seks. Është si një rënie e mah-

nitshme tek era më e natyrshme.

- Vetëdija.

- Të ndesha ty. Ishte e pashmangshme.

- Më pihet.

- Gjithçka përzihet, e djeshmja dhe e tashmja.

U zbatimëm. Në një mënyrë të hareshme dhe shumë nepsqare. Kishim pirë...

Në ato orë që vijuan, ai flinte, hante, fliste e flinte prapë. Kur zgjohej ai zgjohej dhe unë. Zgjohej me të. Sepse më vinte turp ti rrëfeja gjumin tim. E shikoja vjedhurazi. Ndonjëherë. Si i lëviznin kapakët e syve nën lëkurën e zbehtë. E shikoja si ëndërronte. Për kë ëndërronte? Ai lëshonte psherëtima si djalë i vogël.

Mund të tregoj hollësi pa fund për ato orë. Por po i kapërcej. Më mirë ti kapërcej. Vjen momenti i ikjes.

Nxitojmë të kthehemi në vete. Unë duke kërkuar me ngulim motivin e humbur, i cili ma prish humorin, ndërsa ti duke u larguar ashtu si erdhe, qetë, me mendimet e kaltra të arratisjeve.

I gjithi prej eshtrash të ëmbla.

Kur ike, isha gjysmë e plevitusur dhe me kishte kapur dëshira për patate të skuqura dhe një gotë verë.

Kuptova se pranë teje isha ndërë e hutuar, sepse u mundova të gënjeja, të fsheh-

ja zbrazëtinë, nuk isha mësuar të numëroja lumturinë që më kishte dhënë.

Dola në dritare. Një shi i pjerrët më pengonte të shikojta poshtë taksinë që të mori. As shtegun e ngushtë nuk arrita ta dalloja, aq i dendur nisi.

Mendova se kisha një kujtim. Dhe se isha ç'mësuar të kuptoja të vërtetën, kisha ngushtuar kufijtë, i isha dorëzuar së keqes.

Kuptova në ato momente se më kishte ardhur në majë të hundës duke qenë unë, ndjeva të gjithë zbehtësinë e mendimeve të mia.

Kur po mendoja këto, hoqa bluzën dhe çorapet. Tërhuqa kuvertën deri tek gjoksi, si bëj zakonisht kur jam vetëm dhe u ndera e tëra. Shiu vazhonte të binte pa e prishur fillin e mendimeve. Mu kujtua pjerrina plot me baltë, therrat e djegura, shkallët e ftohta, buka e thurur me galpë, zhurma e banjosh kur shkarkohej uji, vera që u derdh mbi tapet, disqet që dëgjuam, dhoma e braktisur me raftet bosh të librave, me perdet e vjetra dhe kornizat e gërryera, gotat e qirinjeve, filxhanët e kafes, më vërshoi gjithë zhgënjimi, varësia, ankthet, ngurrimet, zbrazëtia, frika, drita e mëngjesit, ngjyra e gurëve, ëndrra në shtëpinë e ëndrrave, maskulli i çuditshëm që kishte fjetur në shtratim tim.

Asgjë nuk ma zbuste dot dëshpërimin. Hapa verën. Piva glënjëkën e parë. Aty për aty mu kujtua ajo shprehja e gjyshes time se, mjafton një glënjëkë, për të dalluar se shishja është e mirë.


Opinioni *i* Ditës

Korrupsioni më i rrezikshëm, ai që harrohet!

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

...nga sistemi ynë i drejtësisë, pasi nuk justifikojnë pasuritë e deklaruar po prej tyre. Dhe na duket sikur drejtësia shoqërore më në fund po vihet në vend. Por, për fat të keq, nuk është kështu. Është mëse e vërtetë që gjyqësorin e kemi tejet të korruptuar. Kjo kuptohet nga rreth 38 për qind e gjykatësve dhe prokurorëve të kontrolluar (vetuar) deri tani, që kanë mundur të justifikojnë pasurinë e tyre (flasim gjithnjë për atë që e kanë mbajtur të pafshehur majën e ajsbergut). Mirëpo gjyqtarët dhe prokurorët kanë qenë thjesht sekserë të atyre që lëviznin shuma të mëdha të parasë publike (të të gjithë shqiptarëve) që kanalizoheshin e grabitur në damarë korruptivë. Pra, të politikanëve dhe drejtuesve të administratës shtetërore me të drejtë firme (ministra, drejtorë të përgjithshëm, drejtorë institucionesh qendrore, kryetarë bashkish, etj.). Kanë qenë mbrojtësit, ligjëruesit dhe mbuluesit e korrupsionit të jashtëzakonshëm në administratën shtetërore. Edhe pse janë bërë zëngjijnë pa meritë, përsëri kanë marrë "thërrimet" nga banketi i korrupsionit. Disa dhjetëra miliona euro në 20 vitet e fundit. Ata që kanë lëvizur korrupsionin, që e kanë kryer atë në "fushë të betejës" (në tenderat publikë), duke iu mohuar qytetarëve të këtij vendi shërbime dhe shtetit të shqiptarëve asete publike në nivele 2.8-3 miliardë euro në 20 vitet e fundit, janë politikanë dhe ish-drejtes të administratës sonë shtetërore, ose drejtues të sotëm të saj. Këta politikanë dhe drejtues të ish-drejtuesve të administratës publike ende nuk janë vetuar, kontrolluar. Nuk u janë parë me imtësi pasuritë e tyre, si i kanë krijuar, shtuar, sa kanë realisht tani. Sa u kanë dhënë vëllezërve, motrave, nënës, babait, gjyshërve, sojit e sorollopit. Madje, nuk duket as edhe ndonjë shenjë apo shpresë se do të kontrollohen ndonjëherë. Ende asnjë strukturë shtetërore nuk është ngritur për të hetuar pasurinë e tyre. E megjithatë, ata janë hajdutët më të mëdhenj të Shqipërisë, realizuesit e korrupsionit më masiv, varrosësit e shanseve për një zhvillim të qetë shoqëror dhe të qëndrueshëm ekonomik tonin. Janë po këta politikanë dhe ish-drejtes e drejtues të sotëm të administratës shtetërore, që krijuan dhe po mbajnë në këmbë sot shëmbëllitërinë më të keqe të sipërmarrjes private, pse nuk ka asnjë lloj morali në mënyrën se si është krijuar. Një lloj përbindëshi me dy kokë (një në politikë dhe shtet, dhe një në sektorin privat) dhe njëqind këmbë, të quajtur biznes i lidhur kryekëput me politikën. Banka Europiane për Rindërtim dhe Zh-



villim, në raportin e saj të fundit, të publikuar dy javë më parë, ka vërejtur se afro gjysma e bizneseve në Shqipëri mbijetojnë nga lidhjet me politikën dhe pushtetin. Me fjalë të tjera, quhen të suksesshëm se paguajnë politikanë, ministra dhe kryebashkiakë për të fituar tendera publikë! Këta nuk janë sipërmarrës të suksesshëm, as edhe oligarkë që fituan mbi konkurrencën në treg. Janë vetëm dhe thjesht grabitqarë. Sipërmarrje të tilla ndoshta dhe mund të krijojnë perandori më vete, të punësojnë me qindra e deri mijëra njerëz. Por në realitet, me ngrirjen e konkurrencës së lirë dhe përcudnimin e tregut që kanë

bërë, u kanë mohuar 430 mijë familjeve të thjeshta shqiptare, që jetojnë me djersën e ballit, mijëra shanse për punësim, një nivel jete më dinjitos, si dhe mbi 2 miliardë euro pasuri publike apo shërbime shtetërore të munguara, ose të dhëna keq. Ky është bilanci i trishtë i përbindëshit të quajtur biznes i lidhur si jetë e vdekje me politikën, ku nuk investohet për të formuar kadro drejtues të zotë dhe të ditur, por qokaxhinj të politikantit apo ministrit të radhës. Ky realitet vijon i shtuar si metastaza kanceri edhe në ditët e sotme, i denoncuar më së fundmi nga Departamenti Amerikan i Shtetit, me gjuhën

më të qartë e të ashpër, kur shprehet se korrupsioni po buron përmes ligjeve të dyshimta dhe favorizimeve të bizneseve pranë qeverisë. Ky është korrupsioni më i rrezikshëm, ai që na largon orë e çast nga modeli i një ekonomie dhe shoqërie konkurruese dhe me tipare evropiano-perëndimore. Dhe ky korrupsion i tenderave të trukuara apo të realizuar me një ofertues, i koncesioneve dhe Partneriteteve Publik-Privat nuk po shihet qartë prej nesh si qytetarë, me rrezikun e madh për t'u parë si diçka e natyrshme, për t'u anashkaluar, për t'u lënë të shtohet akoma edhe më shumë, për t'u harruar!

HOROSKOPI

DASHI

Sjellja e një prej miqve tuaj mund t'ju ofendojë, megjithatë përpuni të ruani qetësinë. Do të merrni një lajm shumë të mirë sot, i cili do t'ju lumturtojë pamasë jo vetëm ju, por edhe familjen. Ka gjasa që të realizoni një udhëtim shumë të bukur, i cili do t'ju mbushë me energji dhe pasion.

DEMI

Sot mund të merrni një informacion të rremë, i cili do t'ju merrzi shumë. Mos ndërmerrni vendime të rëndësishme sa u përket investimeve. Bëni kujdes për çdo veprim tuajin, pasi mund të bini preh e mashtrimeve. Çiftet që kanë kohë pranë një-tjetrit mund të ndërmarrin një hap të rëndësishëm si masa, ndërsa për beqarët do të jetë dita e tyre me fat në dashuri.

BINJAKET

Tregojni çdokujt që mund të gjeni zgjidhje për problemet tuaja. Parashikohet rritje e të ardhurave nga investimet e mëparshme. Sa u përket marrëdhënieve në çift, do të kaloni një ditë shumë të bukur me partnerin/partneren tuaj. Dëgjoni këshillat e të tjerëve, pasi sot do të përfitorni prej tyre.

GAFORJA

Ankthi që keni përjetuar gjatë këtyre ditëve do të shuhet, pasi do të merrni nën kontroll situatën. Do të befasoheni nga disa informacione sekrete që do të merrni vesh për familjen tuaj. Sot është një ditë shumë e bukur për të dashuruarit.

LUANI

Shmangni ushqimet me shumë kalori, që të jeni në formë dhe të ndiheni mirë. Fëmijët ka gjasa t'ua bëjnë ditën shumë të vështirë. Mendoni ide të reja që të ngjallin interesin e tyre. Sa u përket marrëdhënieve në çift, sot mund të përballemi me disa debate.

VIRGJERESHA

Duhet të bëheni shumë të fortë, pasi do të përballemi me disa probleme të vështira. Mund ta kaloni këtë situatë duke u treguar optimistë. Bëni shumë kujdes me shpenzimet, në mënyrë që të shmangni çdo gabim që mund t'ju sjellë dëme. Kushtojni vëmendje partnerit/partneres suaj dhe përpuni ta kënaqni atë.

PESHORJA

Sot do të përballemi me disa probleme, por tregohuni realistë dhe mos prisni të ndodhë mrekullia pas ndihmës që do ju japin persona të caktuar. Ka gjasa që sot të merrni një propozim për martesë. Bëni kujdes dhe mos përdorni fjalë të ashpër, pasi mund të përfundoni në konflikt.

AKREPI

Bëni kujdes me ushqimin, mos e kaloni masën e duhur dhe mos e teproni me alkoolin. Bëni mirë që sot të mos qëndroni dukryq, por përfshihuni në aktivitete të ndryshme. Do të kaloni një ditë shumë të kënaqshme në punë.

SHIGJETARI

Natyrë juaj dyshuese mund t'ju përballë me humbjen. Përmirësimet në financa do t'ju bëjnë të kryeni disa shpenzime të rëndësishme. Bëni kujdes me sjelljen, pasi partneri/parteri juaj nuk do të jetë në humorin e duhur. Ka gjasa që sot të vendosni për një udhëtim gjatë ditëve në vijim.

BRICJAPI

Stresi do t'ju bëjë të mos ndiheni shumë mirë sot. Qëndroni me miqë dhe familjarët tuaj, që u bëjnë të ndiheni mirë. Sot do të keni fitime shumë të mira, por do të bëni disa shpenzime prej të cilëve nuk do të mundni të kurseni asgjë.

UJORI

Sot mund të befasoni njëri-tjetër rreth jush me besimin që do tregoni ndaj vetes. Familja juaj ka gjasa të shqetësohet, për shkak të disa problemeve të papritura. Megjithatë, mos u shqetësoni, pasi gjithçka do të kalojë me kohën.

PESHQIT

Përpuni të mendoni pozitivisht që të qilloheni nga çdo frikë. Jepini kohën dhe vëmendjen e duhur familjes. Sot mund të merrni një lajm të mirë në punë, por rivalët tuaj do të përpigjen të hapin thasetheme për t'ju dëmtuar.

Opinion *i* Ditës

Java masakër dhe plot lot e dhimbje.

Nga Zoje Jakaj

(vijon nga faqja 1)

... mendor vrau pa ju dridhur qerpiku 8 veta, mes të cilëve edhe një djalë 9 vjeç e një vajzë adoleshente 17 vjeçe, shtu dhe faktin që të gjithë i kishte kushërinj. Një grua e papërgjegjshme realizoi një masakër në Kodër-Kamëz, duke vrarë një djalë 29 vjeç në biçikletën e tij, i cili po drejtohej për në punë për të ushqyer familjen e tij me bukë dhe ushqim, si dhe vrau një vajzë 7 vjeçe në duart e një nëne dhe therroi atë bashkë me vajzën tjetër, duke i masakruar me makinë. Deri kur të sëmuret psikikë dhe të papërgjegjshmit do marrin jetë të pafajshme njerëzish...? Ajo që më shqetëson më shumë është kur këto dy raste fillojnë dhe i trajtojnë politikisht dhe për të rënë në sy se po bëjnë ndonjë punë të hajrit duke i "shërbyer" popullit të thjeshtë me pseudoshkrime, rastet sipas tyre duhet t'i zgjidhë shteti dhe fajtor është vetë shteti, po cili shtet në botë ndalon dot një të sëmure psikik në një fshat të thellë të rrëmbejë armën kur kjo e fundit gjendet kudo dhe të vrasë tërë fshatin? Cili shtet ndalon një grua të papërgjegjshme të shtypë gazin në vend të frenave e të vrasë njerëz të pafajshëm në mes të rrugës në



punën e tyre? Jo, jo o politikanë të dështuar, nuk ka faj shteti se ka të sëmure psikikë se kjo ndodh në

mbarë botën, edhe në atë më demokratike e me drejtësi të konsoliduar, madje ka ndodhur

edhe kur ishte PD pushtet, pra kur ishit ju që shkruani se paska faj shteti se vret një individ i çmendur

ose se një grua e papërgjegjshme ka marrë patentë të parregullt dhe i jep makinës sa hap e mbyll sytë me shpejtësi, duke vënë këmbën në gaz si e sëmure mendore. Ajo që dua unë të ngre si problematikë dhe shqetësim i madh ndër vite është se fajësoj të gjitha qeveritë në këtë vend për mosmbledhjen e armëve, e cila duhet të bëhet një orë e më parë, si dhe armëmbajtja pa leje të konsiderohet vepër e rëndë penale e ligji të ashpërsohet si një formë detyrimi që t'i dorëzojnë shqiptarët këto mjete shumë të rrezikshme në duart e tyre që sjellin vetëgjyqësi dhe fatkeqësi të atij që vret dhe të asaj familjeje që i vritet familjari. Një pyetje kam për ju që më lexoni sot: A ka ardhur koha dhe a është kthyer në detyrim për të shmangur fatkeqësitë nga dora e njeriut dënimi me vdekje? Këtë duhet ta rregullojë politika dhe parlamenti qoftë i djathtë apo i majtë me ligje dhe me nene të veçanta e të plota në Kushtetutë dhe Kod Ligjor, që kush vret duhet të dënohet me burgim përjetshëm, ose jeta e tij të pritë në mes ashtu, sikurse ai ose ajo mori jetë... Askush pa një rregullim me ligj dhe zhdukjen nga duart e popullit të armëve në këtë vend nuk e ka jetën të sigurt! Zoti i mbroftë jetët e njerëzve!

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET


KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Fjalëkryqi (1)



- 38. Fillojnë vonë.
- 39. Krijoi James Bond.
- 40. Ishulli i Odiseut.
- 42. Van der portier.
- 43. Një karamelle aromatike.
- 44. Mund të shkojnë... nga frika.

- VERTIKAL**
- 1. Bëhet duke vënë në lojë.
 - 2. Pak origjinale.
 - 3. Thahet me bonifikim
 - 4. Në fund djathtas.
 - 5. Ishte Gjermania e Honecker-it.
 - 7. Hidhet një për shesh.
 - 9. Kokëkuqja në pit stop.
 - 10. I famshëm ai i Sizifit.
 - 12. Eshhtë në pikën më veriore e Shqipërisë.
 - 13. Një diktator shtypës

- VERTIKAL**
- 1. Të çara ato të Shollohov.
 - 5. Fillojë luftën.
 - 6. Liszt kompozitor.
 - 8. Marsi në Areopag.
 - 9. Kështu fillon filmi.
 - 11. Gjysmë linear.
 - 12. Një freskues në tavan.
 - 18. Eshhtë gazeta Panorama.
 - 20. Mund të jenë kamikaze.
 - 21. Masat pa kufij
 - 23. Venier e spektaklit italian.
 - 25. Sophia e kinemasë.
 - 26. Safin tenis.
 - 29. Eshhtë makut, i pangopur.
 - 31. Eshhtë faqe ene.
 - 32. Një kafshë që hap... galeri.
 - 33. Një fytyrë e keqe.
 - 35. Preken nga sindroma Basedow.
 - 37. Italia në Internet.


- 14. Lëvizja Socialiste Spanjole.
- 15. I kanë çift radhët.
- 16. Janë llahtarë.
- 17. Poeti kur nuk pi.
- 19. Fillojnë periudhën.
- 22. Omar që qe aktor.
- 24. Si sezonale.
- 25. Janë banorët në Riga.
- 26. Carey këngëtare.
- 27. Nuk i tregohen babait.
- 28. Bëjnë arte me re.
- 29. Kush ka... e ka humbur toruan.
- 30. Një stacion orbital.
- 31. Fillojnë profesionin.
- 33. Gibernau i MotoGp.
- 34. I kanë të ndryshme tutat
- 36. Gjysmë ditari.
- 38. Varet me re.
- 41. Kufijtë e kujtesës.
- 42. Sapo fillojnë.

Fjalëkryqi (2)

- HORIZONTAL**
- 1. Gustav kompozitor.
 - 6. Në krye të kryesisë.
 - 7. Lexohet në pentagram.
 - 11. Sastre aktore.
 - 12. Gjysmë akordi.
 - 15. Dhjetë angleze.
 - 16. Satira për zë.
 - 18. Eshhtë situata e tensionuar.
 - 21. Pak teatrale.
 - 22. Bëhet me mea culpa.
 - 24. Fundi i një samurai.
 - 25. Mbeten në fund.
 - 26. Lind në kokë.
 - 28. Në radhë të parë.
 - 29. Iniciale e Camus
 - 30. Një verë në Paris.
 - 31. Partizani i vogël... në një film tonin.
 - 33. Litra pa kufij.
 - 35. Eshhtë fatë.


- 36. Një pjesë e kinematografisë.
- 37. Një pjesë e akademisë.
- 39. Kufijtë e tretjes.
- 40. Mbyllt të çarën.
- 41. Erik çiklist.
- 43. Një pjesë e medaljes.
- 44. Njësi matëse e shpërthimit atomik.
- 46. Pak torturuese.
- 48. Ka privilegjin e jetës
- 51. Mbyllin një spital.
- 52. Mbyllet me dorezë.
- 53. Ishin kalorësit si Rolandi
- 54. Ndal në... kryqëzim.

- VERTIKAL**
- 1. Janë enigmatikë.
 - 2. Mund të jenë parabolike.
 - 3. Ishte xhelozia e Olimpkit.
 - 4. Kufijtë e lëvizjes.
 - 5. Fillojnë radhitjen.




- 6. Janë kushte.
- 8. Tëtem pa ekstreme.
- 9. Mbyllin kanate.
- 10. Shoqëronte Edipin e verbër.
- 13. Eshhtë gjeli.
- 14. Moore aktore.
- 17. Janë forcat e Reneas.
- 19. Janë përmasa.
- 20. Fund dhjetori.
- 23. Mbyllin dritaren.
- 26. Fillojnë matjet.
- 27. Duhet ruajtur.
- 32. I bën një serenatë Rosina-s.
- 34. Gjysmë rabini
- 38. Mustafa.. Ataturk.
- 40. Të parat në Amsterdam.
- 42. Ai i muzave është Helikona.
- 45. Një pjesë e gadishullit
- 47. Muzika e Eminem.
- 49. Fillojnë operacionin.
- 50. Kapen të parat.
- 52. Kufijtë e drejtëzës.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

H	E	S	A	P	E	T	T	P	A	B	C
E	M	I	R	A	T	E	A	R	A	B	E
T	I	K	E	R	B	E	T	O	N	E	T
E	L	S	A	D	R	I	V	A	L	E	T
N	R	B	U	R	I	M	E	T	J	A	T
M	A	R	O	K	E	N	E	O	D	A	T
F	U	L	L	A	N	I	E	M	E	K	A
P	L	A	A	T	O	M	I	K	E	A	
A	N	S	T	E	R	E	O	L	T	A	
P	A	R	A	S	D	M	A	R	I	A	
A	N	A	N	I	A	P	R	E	S	I	O
S	A	R	D	O	U	D	E	T	I	T	A

FJALËKRYQI (2)

P	A	R	A	G	R	A	F	I	I	V	A	N
I	R	O	N	I	A	O	S	E	R	A		
R	A	B	A	T	B	A	N	A	R	A		
A	M	E	T	A	N	V	R	I	M	A		
T	I	R	T	E	L	E	M	A	K	U	E	L
S	P	O	L	E	M	I	K	A	E	L		
V	K	A	N	A	R	I	N	A	I	E	N	A
A	L	V	A	T	I	R	A	N	I	E	N	A
J	O	E	T	A	N	E	T	E	M	A		
R	I	M	A	R	A	D	E	T	I	A		
T	A	L	E	N	T	M	A	U	R	I	C	E

SUDOK

1	8			3		7	
				8			
3	6		7		2	4	
	4				6		
	2						7
							3
4	1	7				6	
	5		8	2	4		
			6	9			

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	1	2	7	9	3	8	5	4
3	4	5	8	1	2	9	6	7
7	8	9	4	6	5	1	3	2
9	3	1	5	7	4	2	8	6
8	5	6	9	2	1	4	7	3
4	2	7	6	3	8	5	9	1
5	6	4	1	8	7	3	2	9
1	7	3	2	5	9	6	4	8
2	9	8	3	4	6	7	1	5

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Ti e harron fajin tënd kur ia tregon një tjetri, por zakonisht tjetri nuk e harron.

- Askush nuk flet më me shumë pasion për të drejtën e tij sesa ai që, në thelb të shpirtit, ka një dyshim për të drejtën e tij.

- Dashuria dëshiron, frika mënjanon. Nga kjo varet fakti që nuk mund të jesh, të paktën në të njëjtën kohë, edhe i respektuar edhe i dashuruar nga i njëjti person.

- Një kafshë që do të dinte të fliste, do të thoshte: "Njerëzimi është një paragjykim nga i cili të paktën ne kafshët e tjera nuk vuajmë".

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

12	6	10	2		15	10		15	1	11			
1	9	3	7		8	2	7	16		11	1		
4	1	10		5	3	9	3	8	2	12	3	8	
2	9		16	6	4	2	8	6	9	2			
18		12	1	15	2	8	1	11	2	7	8	3	
6		11	1	15	9	1	8		1	1	8		
4	3	1		3	8			11	16	8	2	16	
2		7		9	3	2	4	3		8	2	16	
	15	2	7			7	S	O	D	A		16	6
7	3	12	9	3	8		11		17	6	11		
1	11	3		11	6	4	10	9	1		9	6	
8	3	8		1	18	10	3	9	1		3	17	

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

C	R	A	L	K	I	M	I	S	T	I		
C	O	S	T	N	E	R	P	A	V			
I	L	R	M	I	I	K	L	A				
R	K	O	P	E	R	N	I	K	U	N		
K	O	O	P	E	R	A	T	I	V	A	T	
K	L	I	N	I	K	E	L	F				
T	R	O	K	E	I	R	O	N	I	K	E	
R	S	A	L	T	E	V	I	T	A			
I	T	A	L	I	A	S	E	E	V	A		
U	L	E	M	A	R	T	A	C				
M	A	E	J	E	A	N	L	I	J	A		
F	U	T	U	R	I	S	T	E	T	A	R	

Thënie të mençura

- Për të veshur një grua, duhet të zhvishen dy kafshë: një që i jep gjunë dhe ai që paguan.
- Unë jam me të vërtetë i pasur, sepse të ardhurat e mia janë më të larta se shpenzimet e mia dhe shpenzimet e mia janë të barabarta me dëshirat e mia.
- Nëse ju doni të martoheni me një grua të bukur, të inteligjente dhe e pasur, atëherë ju duhet të martoheni tri here.
- Ka nga ata që shohin gjërat ashtu si janë dhe pyesin pse. Unë ndërroj gjëra që kurrë nuk kanë ekzistuar dhe pyes: pse jo?

